



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Nr. 386 Akti

Nr. 513 Vendimi  
Tiranë, më 25.2.2022

V E N D I M

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

<b>Etleda Çiftja</b>	Kryesuese
<b>Roland Ilia</b>	Relator
<b>Pamela Qirko</b>	Anëtare

asistuar nga sekretare gjyqësore, znj. Amela Idrizi, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Francesco Ciardi, në datën 22.2.2021, në orën 12:00, në Pallatin e Koncerteve (ish-Pallati i Kongreseve), salla B, kati 0 (*underground*), Tiranë, mori në shqyrtim në seancë dëgjimore publike çështjen që i përket:

**SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT:** **Znj. Flutura Hoxha**, me detyrë gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Pukë.

**OBJEKTI:** **Rivlerësimi kalimtar i subjektit të rivlerësimit.**

**BAZA LIGJORE:** **Neni 179/b dhe nenet A, Ç, D, DH dhe E të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë**, miratuar me ligjin nr. 76/2016, datë 22.7.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, e ndryshuar;

**Ligji nr. 84/2016**, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;

**Ligji nr. 44/2015**, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”;

**Ligji nr. 49/2012**, “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative.

## TRUPI GJYKUES I KOMISIONIT TË PAVARUR TË KUALIFIKIMIT

pasi dëgjoi relatorin e çështjes, komisioner Roland Ilia, dëgjoi subjektin e rivlerësimit, vëzhguesin ndërkombëtar, pasi shqyrtoi në tërësinë e saj çështjen që i përket rivlerësimit kalimtar të subjektit të rivlerësimit Flutura Hoxha, e cila në seancën dëgjimore publike kërkoi konfirmimin në detyrë,

### V Ë R E N:

#### I. RRETHANAT E ÇËSHTJES

1. Komisioni i Pavarur i Kualifikimit është institucioni që kryen procesin e rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve, bazuar në paragrafin 5, të nenit 179/b, të ligjit nr. 76/2016, datë 22.7.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, si dhe në pikën 5 të nenit 3 dhe në pikën 1, të nenit 5, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.
2. Subjekti i rivlerësimit Flutura Hoxha, me detyrë gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Pukë, është subjekt i rivlerësimit që i nënshtrohet rivlerësimit *ex officio* në bazë të pikës 3, të nenit 179/b, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.
3. Bazuar në pikën 2, të nenit 14, të ligjit nr. 84/2016 dhe në rregulloren “Për procedurat e zhvillimit të shortit në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit”, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (në vijim Komisioni) ka hedhur shortin në muajin dhjetor të vitit 2019, nga i cili rezultoi se subjekti i rivlerësimit Flutura Hoxha do t’i nënshtrohet procesit të rivlerësimit nga trupi gjykues nr. 1, i përbërë nga komisionerët Pamela Qirko, Roland Ilia dhe Etleda Çiftja.
4. Për këtë subjekt rivlerësimi u caktua me mirëkuptim kryesues i trupit gjykues komisionere Etleda Çiftja, u deklarua mospasja e konfliktit të interesit nga anëtarët e trupit gjykues, si dhe u vendos fillimi i hetimit administrativ, me qëllim kryerjen e procedurave të rivlerësimit për subjektin e rivlerësimit Flutura Hoxha.
5. Në referim të pikës 1, të nenit 4, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, për subjektin e rivlerësimit Flutura Hoxha nisi procesi i rivlerësimit dhe hetimi i thelluar administrativ.
6. Procesi i vlerësimit të pasurisë për subjektin e rivlerësimit, në përputhje me kreun IV, “Vlerësimi i pasurisë”, të ligjit nr. 84/2016 dhe, veçanërisht, në nenin 30 të këtij ligji kishte për objekt të vlerësimit deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të ligjshmërisë së burimit të krijimit të tyre, të përmbushjes së detyrimeve financiare, përfshirë interesat private për subjektin e rivlerësimit dhe për personat e lidhur me të.
7. Bazuar në nenet 33, 39 dhe 43 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, në Komision janë administruar raportet e hartuara nga institucionet: Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim ILDKPKI); Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (në vijim DSIK) dhe Këshilli i Lartë Gjyqësor (në vijim KLGJ). Këto raporte janë administruar nga relatori me fillimin e hetimit administrativ.
8. Në përputhje me nenet 30-33 të ligjit nr. 84/2016 u administrua akti i kontrollit me nr. \*\*\* prot., datë 17.4.2018, i ILDKPKI-së, protokolluar në Komision me nr. \*\*\*, datë 18.6.2019, ku

është kryer një procedurë kontrolli për vlerësimin e pasurisë së subjektit Flutura Hoxha, me detyrë gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Pukë.

**9.** DSIK-ja ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit me anë të verifikimit të deklarimeve dhe të dhënave të tjera, me qëllim që të identifikohet nëse subjekti i rivlerësimit ka kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës dhe në ligjin nr. 84/2016. Për këtë qëllim, DSIK-ja ka dërguar një raport për subjektin e rivlerësimit me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 24.1.2022 (deklasifikuar plotësisht me vendimin nr. \*\*\*, datë 21.1.2022, të KDZH-së), në përputhje me nenin 39 të ligjit nr. 84/2016.

**10.** KLGJ-ja ka kryer vlerësimin e aftësive profesionale bazuar në ligjin nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, në ligjin nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, në të dhënat e rezultuara nga tri dokumentet ligjore të përzgjedhura nga subjekti, pesë dokumentet ligjore të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor dhe nga të dhënat arkivore të këtij Këshilli. Raporti me nr. \*\*\* prot., datë 23.7.2018, i vlerësimit të aftësive profesionale për subjektin e rivlerësimit, është protokolluar në Komision me nr. \*\*\* prot., datë 25.7.2018.

**11.** Në vijim, relatori i çështjes ka ndjekur procedurat ligjore të përcaktuara në pikën 5, të nenit 14, të ligjit nr. 84/2016, duke kryer një hetim të plotë dhe të gjithanshëm për të tria kriteret e vlerësimit: pasurisë, kontrollit të figurës, si dhe aftësive profesionale.

**12.** Trupi gjykues, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, pasi u njoh me rezultatet e hetimit dhe provat e grumbulluara për të tria kriteret e vlerësimit – vlerësimi i pasurisë, kontrolli i figurës dhe vlerësimi i aftësive profesionale, në datën 28.1.2022, vendosi: (i) përfundimin e hetimit kryesisht për të tria kriteret e vlerësimit për subjektin e rivlerësimit Flutura Hoxha; (ii) njoftimin e subjektit për t’u njohur me materialet e dosjes; si dhe (iii) kalimin e barrës së provës subjektit për të paraqitur shpjegime të tjera për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit, mbështetur në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016.

**13.** Subjekti i rivlerësimit u njoftua në datën 14.2.2022 mbi të drejtën e tij për të paraqitur pretendime/shpjegime shtesë apo të kërkojë marrjen e provave të reja lidhur me rezultatet e hetimit kryesisht të zhvilluar nga Komisioni. Subjekti, pasi u njoh me aktet e dosjes, ushtroi të drejtën e paraqitjes së parashtrimeve dhe provave të reja deri më 18.2.2022.

**14.** Subjekti i rivlerësimit, pasi u njoh me dosjen dhe ka marrë një kopje të saj, ka dërguar shpjegimet në rrugë zyrtare. Trupi gjykues, pasi mori në shqyrtim shpjegimet e paraqitura dhe provat mbështetëse mbi rezultatet e hetimit në datën 14.2.2022, vendosi të ftojë znj. Flutura Hoxha në seancë dëgjimore, në përputhje me nenin 55 të ligjit nr. 84/2016.

## **II. SEANCA DËGJIMORE**

**15.** Subjekti i rivlerësimit Flutura Hoxha u ftua në seancë dëgjimore me njoftimin e bërë elektronikisht me *e-mail*, në datën 14.2.2022.

**16.** Seanca dëgjimore me subjektin e rivlerësimit u zhvillua në përputhje me kërkesat e nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, në datën 22.2.2022, në orën 12:00, në Pallatin e Koncerteve (ish-Pallati i Kongreseve), salla B, kati 0 (*underground*), Tiranë, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar.

17. Subjekti i rivlerësimit mori kohën e kërkuar për të shprehur dhe për të parashtruar shpjegimet dhe opinionet e saj në lidhje me procesin e rivlerësimit të kryer ndaj saj. Në përfundim të shpjegimeve dhe të parashtrimeve, subjekti i rivlerësimit Flutura Hoxha kërkoi nga Komisioni konfirmimin në detyrë.

### III. QËNDRIMI DHE MENDIMI I SUBJEKTIT TË RIVLERËSIMIT

18. Znj. Flutura Hoxha ka qenë bashkëpunuese në procesin e rivlerësimit të kryer ndaj saj, duke u përgjigjur kur është kërkuar, sipas nenit 48 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” dhe gjatë gjithë procedurës së hetimit administrativ ka zbatuar afatet e përcaktuara nga Komisioni, si dhe ka sjellë prova dhe shpjegime kur i janë kërkuar. Subjekti ka qenë korrekte dhe e gatshme për bashkëpunim gjatë të gjitha fazave të hetimit, si dhe gjatë zhvillimit të seancës dëgjimore.

### IV. PROCESI I RIVLERËSIMIT/HETIMI I KRYER NGA KOMISIONI

19. Procesi i rivlerësimit, që kryhet nga Komisioni, është një proces kushtetues që mbështetet në nenin 179/b dhe në Aneksin e Kushtetutës, si dhe në ligjin nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”. Ky proces kryhet me qëllim që të garantohet funksionimi i shtetit të së drejtës, pavarësia e sistemit të drejtësisë, me synim rikthimin e besimit të publikut tek institucionet e këtij sistemi.

20. Parashikimet e ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, kanë përcaktuar qartë të gjitha rregullat e posaçme për kryerjen e rivlerësimit mbi bazën e parimeve të barazisë përpara ligjit, të kushtetutshmërisë e ligjshmërisë, të proporcionalitetit dhe të parimeve të tjera që garantojnë të drejtën e subjekteve të rivlerësimit për një proces të rregullt ligjor.

20.1 Sipas kreut IV të ligjit nr. 84/2016, ILDKPKI-ja është organi kompetent shtetëror i ngarkuar me ligj për të bërë vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit dhe për të marrë vendim në lidhje me vlerësimin pasuror.

20.2 Sipas kreut V të ligjit nr. 84/2016, DSIK-ja është organi kompetent shtetëror i ngarkuar me ligj për të bërë vlerësimin e figurës dhe për të marrë vendim në lidhje me kontrollin e figurës.

20.3 Ndërsa, sipas kreut VI të ligjit nr. 84/2016 parashikohet objekti i rivlerësimit të aftësive profesionale dhe procedura që duhet të ndiqet nga organet ndihmëse.

21. Referuar vendimit nr. 2/2017<sup>1</sup> të Gjykatës Kushtetuese dhe kreut VII të ligjit nr. 84/2016, rezulton se Komisioni, në kryerjen e funksionit të tij kushtetues, realizon një proces të mirëfilltë

---

<sup>1</sup>“41. Për rrjedhojë, gjykata vlerëson se pretendimi se organet ekzistuese zëvendësojnë organet e reja të rivlerësimit është i pabazuar. Sipas nenit 179/b, pika 5 e Kushtetutës rivlerësimi kryhet nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, kurse sipas nenit 4/2 të ligjit: ‘Komisioni dhe Kolegji i Apelit janë institucionet që vendosin për vlerësimin përfundimtar të subjekteve të rivlerësimit’. Pavarësisht formulimit të kësaj dispozite, ajo nuk mund të lexohet në mënyrë të shkëputur, por në harmoni me dispozitat e tjera ligjore që përcaktojnë në mënyrë të detajuar kompetencat e organeve të përfshira në proces, si dhe kompetencat që kryen vetë Komisioni gjatë këtij procesi. Në nenin 5/1 të ligjit parashikohet se: ‘Procesi i rivlerësimit të subjekteve të rivlerësimit kryhet nga Komisioni, Kolegji i Apelit, Komisionerët Publikë, në bashkëpunim me vëzhguesit ndërkombëtarë’. Po ashtu, siç u përmend edhe më sipër, bazuar në dispozitat e kreut VII të ligjit nr. 84/2016, rezulton se në kryerjen e funksionit të tyre kushtetues organet e rivlerësimit kryejnë një proces të mirëfilltë kontrolli dhe vlerësimi dhe nuk bazohen dhe as janë të detyruara nga përfundimet e paraqitura atyre nga organet e tjera ndihmëse”.

kontrolli dhe rivlerësimi që nuk bazohet dhe as është i detyruar nga përfundimet e paraqitura nga organet e tjera ndihmëse.

**22.** Bazuar në nenet 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni kreu hetim dhe vlerësim të të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit, duke marrë në analizë:

- a) provat e dorëzuara nga subjekti në ILDKPKI me deklaratën e pasurisë për rivlerësimin kalimtar *Vetting*;
- b) raportin e dorëzuar në Komision nga ILDKPKI-ja;
- c) deklaratën e rivlerësimit kalimtar *Vetting* dhe deklaratat periodike vjetore të dorëzuara, ndër vite, nga subjekti në ILDKPKI;
- ç) provat shkresore/dokumentet e administruara nga organet publike dhe private në përputhje me nenet 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016;
- d) raportin e kontrollit të figurës të dorëzuar në Komision nga DSIK-ja;
- dh) raportin e analizimit të aftësive profesionale të dorëzuar në Komision nga KLGJ-ja;
- e) shpjegimet me shkrim të subjektit të rivlerësimit të depozituar nëpërmjet postës elektronike, si dhe ato gjatë seancës dëgjimore për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit.

## **A. VLERËSIMI I PASURISË**

### **A/1. Vlerësimi i pasurisë nga ILDKPKI-ja**

**23.** ILDKPKI-ja ka kryer një procedurë kontrolli për vlerësimin e pasurisë referuar neneve 30-33 të ligjit nr. 84/2016, ka dërguar aktin e përfundimit të kontrollit të plotë të deklaratës së pasurisë së subjektit Flutura Hoxha, me detyrë gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Pukë, ku në përfundim të veprimeve verifikuese të kryera lidhur me këtë subjekt të rivlerësimit, ka konstatuar se:

- *deklarimi nuk është i saktë në përputhje me ligjin;*
- *ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;*
- *nuk ka kryer fshehje të pasurisë;*
- *nuk ka kryer deklaram të rremë;*
- *subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.*

**24.** Znj. Flutura Hoxha është bërë subjekt deklarues në ILDKPKI në vitin 2003 me nr. indeksi \*\*\* dhe në zbatim të ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003, “Për deklarin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, i ndryshuar dhe të ligjit nr. \*\*\*, datë 7.4.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, i ndryshuar, ka dorëzuar, ndër vite, deklaratat e interesave private: (i) para fillimit të detyrës, vitit 2003; (ii) periodike vjetore për vitet 2004 – 2017; (iii) deklaratën e pasurisë së rivlerësimit kalimtar *Vetting*, për efekt të ligjit nr. 84/2016.

### **A/2. Rivlerësimi i pasurisë nga Komisioni**

**25.** Bazuar në nenet 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni kreu hetim dhe vlerësim të të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit, duke marrë në analizë:

- a) provat e dorëzuara nga subjekti në ILDKPKI në deklaratën e pasurisë për rivlerësimin kalimtar *Vetting*;

- b) raportin e dorëzuar në Komision nga ILDKPKI-ja;
- c) provat shkresore/dokumentet të/e administruara nga organet publike dhe private në përputhje me nenet 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016;
- ç) deklaratimet e subjektit me anë të komunikimit elektronik;
- d) shpjegimet me shkrim të subjektit të rivlerësimit.

**26.** Përtej raportit të dërguar nga ILDKPKI-ja dhe në përputhje me pikën 5, të nenit 32, të ligjit nr. 84/2016, Komisioni nisi shqyrtimin e deklaratimeve të interesave private dhe pasurore, të paraqitura më parë te ky institucion, duke i krahasuar me dokumentet e tjera të marra gjatë hetimit administrativ dhe duke përgatitur për këtë qëllim një relacion që pasqyron procesin e kryerjes së vlerësimit të pasurisë së subjektit të rivlerësimit Flutura Hoxha, pas:

- a) shqyrtimit të të dhënave të deklaratës së rivlerësimit kalimtar *Vetting*, me nr. indeksi \*\*\*, për subjektin e rivlerësimit;
- b) krahasimit të deklaratave të pasurive të dorëzuara në ILDKPKI për periudhën 2003 – 2016, në raport me të dhënat në deklaratën e rivlerësimit kalimtar *Vetting*;
- c) shqyrtimit të të dhënave nga të gjitha bankat e nivelit të dytë, institucionet financiare dhe jofinanciare, zyrat vendore të regjistrimit të pasurive të paluajtshme, organet tatimore, organet e tjera shtetërore, personat juridikë, individët, si dhe likuiditeteve – gjendje *cash*;
- ç) hetimit të kryer lidhur me të dhënat e vetëdeklaruara nga subjekti gjatë plotësimit të pyetësorëve të dërguar nga Komisioni.

**Në deklaratën e pasurisë *Vetting*, të dorëzuar në ILDKPKI, subjekti i rivlerësimit Flutura Hoxha ka deklaruar pasuritë si vijojnë:**

### **1. Llogari page në “Raiffeisen Bank”**

Subjekti, në deklaratën *Vetting*, ka deklaruar llogari page në “Raiffeisen Bank”, e krijuar me kursimet nga paga si gjyqtare. Gjendja në datën e deklarimit është në vlerën 634,143,94 lekë. Pjesa takuese: 100%.

#### **Hetimi i kryer nga Komisioni**

**1.1** “Raiffeisen Bank”, me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 10.7.2017, ka konfirmuar llogarinë rrjedhëse në emër të subjektit Flutura Hoxha (llogari page) me vlerë 666,143 lekë, më 29.1.2017.

**1.2** Nga dokumentacioni shkresor i administruar në dosje me nr. \*\*\*, datë 6.5.2020, konfirmohet llogaria e pagës në “Raiffeisen Bank”, me gjendje në datën 29.1.2017, në vlerën 666,143 lekë.

**1.3** Subjekti nuk i ka bashkëlidhur deklaratës *Vetting* ndonjë dokument provues për këtë llogari bankare.

**1.4** Rezultoi se kjo është një llogari page e krijuar ndër vite, e krijuar nga të ardhurat e marrëdhënies së punës si gjyqtare dhe si inspektore në ish-KLD.

**1.5** Nuk u konstatuan problematika nga Komisioni për këtë llogari rrjedhëse dhe duket se subjekti ka deklaruar saktë këtë llogari bankare. Gjendja e likuiditeteve dhe ndryshimet në këtë llogari rrjedhëse bankare janë pasqyruar në analizën financiare për vitet 2003 – 2016.

## **2. Shuma të kursyera dhënë prindërve**

**2.1** Subjekti, në deklaratën *Vetting* ka deklaruar: *“Shumat e tjera të kursyera deri në vitin 2015 dhënë babait B.H dhe nënës R.H”*.

**2.2** ILDKPKI-ja, për këtë deklaram të subjektit, ka konstatuar: *“Pasaktësi lidhur me shumat e kursyera, të cilat i janë dhënë babait dhe nënës pasi nuk është deklaruar sa është vlera e tyre, gjithashtu në deklaratat e interesave private në vite nuk është shprehur në lidhje me këtë fakt”*.

### **Hetimi i Komisionit**

**2.3** Subjekti, në këtë deklaratë, nuk ka deklaruar vlerën e shumave të kursyera që i ka dhënë prindërve dhe as datën e saktë të dhënies së shumave të pretenduara (detyrim i përcaktuar nga ligji nr. 84/2016).

**2.4** Subjekti nuk i ka bashkëlidhur deklaratës ndonjë dokument shkresor provues për dhënien e këtyre shumave monetare.

**2.5** Referuar deklaratave të interesave private vjetore për periudhën 2004 – 2007, dorëzuar në ILDKPKI, subjekti ka deklaruar kursime *cash* në vlerën totale progresive 2,000,000 lekë, por në këto deklarata dhe në deklaratat periodike vjetore në vijim deri në vitin 2017 nuk ka deklaruar asnjëherë dhënien e kursimeve *cash* prindërve të saj apo ndryshim (zvogëlim) të gjendjes *cash*.

**2.6** Subjekti<sup>2</sup> është pyetur të deklarojë se sa kanë qenë shumat e dhuruara prindërve në periudhat përkatëse dhe pse nuk janë deklaruar këto dhurime në DPV-të përkatëse të dorëzuara në ILDKPKI.

**2.7** Në përgjigje të pyetësorit nr. \*\*\* subjekti ka deklaruar: *“Lidhur me gjendjen cash, ndër vite, nuk kam mbajtur shënime, përveç asaj të deklaruar në deklaratat periodike. Pas vitit 2015, gjendja cash është shuma e kursyer nga vitet paraardhëse dhe shumat nga paga dhe të ardhurat e tjera”*.

**2.8** Komisioni i ka kërkuar subjektit që të saktësojë ndryshimin e gjendjes *cash* në banesë për periudhën 2003 – 2017.

**2.9** Në përgjigje të pyetësorit nr. \*\*\*, subjekti ka deklaruar: *“Gjendja cash e krijuar nga viti 2003 deri në vitin 2007 është shuma e kursyer nga paga dhe të ardhurat e tjera që rezultojnë nga marrëdhënia e punës që reflektohen edhe nga lëvizjet e bëra në llogarinë rrjedhëse. Pjesa më e madhe e këtyre kursimeve u është dhënë prindërve, ndër vite, për të mbuluar shpenzimet e jetesës dhe shpenzime të tjera në formë kontributi familjar. Në këtë kontekst nuk ka qenë një dhurim në vlerën totale të vlerës cash të deklaruar në deklaratat periodike, por kontribute në vlera dhe periudha të ndryshme. Pas vitit 2007 nuk kam pasur gjendje cash në shtëpi, rrjedhimisht nuk kam shtim apo pakësim të gjendjes cash, por kam pasur vetëm debitime të llogarisë së pagës për nevojat e jetesës sime dhe familjes”*.

**2.10** Kjo përgjigje e subjektit bie në kundërshtim më përgjigjen më sipër (pika 2.7), ku ka deklaruar se *pas vitit 2015, gjendja cash është shuma e kursyer nga vitet paraardhëse dhe shumat nga paga dhe të ardhurat e tjera*, si dhe me deklaratën *Vetting* ku ka deklaruar *shumat e tjera të kursyera deri në vitin 2015, dhënë babait B.H dhe nënës R.H*.

---

<sup>2</sup>Shihni pyetësorin nr. \*\*\*, dërguar subjektit të rivlerësimit.

**2.11** Më poshtë subjekti ka paraqitur dhe një pasqyrë në formë tabelare të të ardhurave të pretenduara nga paga dhe shpërblime të lidhura me të, të cilat reflektohen edhe në statement të llogarisë:

Viti	Të ardhurat nga paga (në lekë)	Balanca në datën 31 dhjetor (në lekë)
2003	680,288	-
2004	906,400	-
2005	1,028,599	118,351.83
2006	1,050,966	139,012.60
2007	1,153,268.13	44,761.21
2008	1,205,835	-161,514.38
2009	1,864,712.14	153,193.07
2010	1,181,263.63	50,275.14
2011	1,159,061.56	9,071.13
2012	1,100,095.8	-85,018.82
2013	1,155,618.42	-48,683.93
2014	1,314,244.61	-159,586.61
2015	1,468,755.27	404,074.94
2016	1,488,056.73	610,621.94
2017	1,439,931.48	669,043.44

**2.12** Rezultoi se subjekti nuk ka deklaruar ndryshimin (zvogëlimin) e gjendjes *cash*, ndër vite, (bazuar në DPV-të periodike për vitet 2007 – 2016). Në analizën financiare gjendja *cash* e akumuluar deri në vitin 2007 (bazuar në DPV) është trajtuar si gjendje *cash* e pandryshuar deri në fund të vitit 2016.

**2.13** Subjekti, në përgjigje të pyetësorit standard, ka deklaruar: “Kontribut për shpenzime të kryera për shtëpinë e prindërve në rrugën ‘\*\*\*’, Tiranë, nga viti 2008 e në vazhdim, në blerjen e pajisjeve: televizor, blerë në shumën 40,000 lekë; lavatriçe, blerë në shumën 30,000 lekë; frigorifer, blerë në shumën 50,000 lekë; dhomë gjumi, blerë në shumën 110,000 lekë; kënd ndenje, blerë në shumën 60,000 lekë; kundrabufe, blerë në shumën 100,000 lekë; tavolinë ngrënieje, blerë në shumën 25,000 lekë; sobë me korrent në shumën 50,000 lekë; dhe dhomë gjumi në shumën 80,000 lekë”.

**2.14** Në përgjigje të pyetësorit nr. \*\*\* në lidhje me saktësimin në vitet përkatëse për blerjen e këtyre pajisjeve, subjekti ka deklaruar se: “Vlerat për blerjen e këtyre pasurive i përkasin viteve 2008 -2009, referuar edhe lëvizjeve të llogarisë sipas statementit të këtyre viteve, ku reflektohen qartë debitimet që korrespondojnë me çmimet sipas listës sa më lart”. Këto vlera të deklaruara nga subjekti janë përfshirë si shpenzime në analizën financiare.



**2.15** Vlera progresive e kursimeve *cash*, të deklaruara nga subjekti në deklaratat periodike, rezultoi 2,000,000 lekë. Kjo vlerë arrihet në vitin 2007 dhe, pas këtij viti, nuk ka asnjë deklaram për kursimet *cash* nga subjekti. Në analizën financiare kjo gjendje progresive mbartet deri në fund të vitit 2016. Në deklaratën *Vetting* subjekti nuk deklaroi kursime *cash*. Ndërkohë që në përgjigje të pyetësorëve, subjekti ka bërë deklarime kontradiktore lidhur me kursimet *cash* dhe përdorimin e tyre.

**2.16** Në përfundim të hetimit, Komisioni hartoi konkluzione për të cilat i kaloi barrën e provës subjektivit të rivlerësimit si vijon:

- Në analizën financiare kursimet *cash* janë vlerësuar sipas deklarimeve periodike të subjektivit në deklaratat periodike për periudhën 2003 – 2016.
- Ka një mospërputhje mes deklaramit për kursimet *cash* në deklaratat periodike dhe me vetë deklaramet e bëra nga subjekti në deklaratën *Vetting* dhe në përgjigje të pyetësorëve.
- Subjekti ka bërë deklaram të pasaktë lidhur me kursimet *cash* dhe gjendjen e tyre në fund të viteve përkatëse. Subjekti nuk ka deklaruar shumat e dhuruara prindërve dhe ndryshimet *cash* në DPV-të periodike.
- Për mundësitë financiare për krijimin e këtyre kursimeve *cash* për vitet 2004 – 2007, shihni tabelën në analizën financiare në pikën 8 të rezultateve të hetimit.

**2.17** Për sa më sipër, subjektivit të rivlerësimit iu la barrë prove për të dhënë argumente dhe paraqitur prova për të provuar të kundërtën e konstatimeve të bëra nga Komisioni, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016.

### **Qëndrimi i subjektivit të rivlerësimit**

**2.18** Në përgjigje të rezultateve të hetimit, subjekti deklaroi se: *“Konstatimi i Komisionit është i drejtë dhe kam bashkëjetuar me prindërit e mi përgjatë gjithë periudhës. Nisur nga statusi im shoqëror, beqare, lidhja ime me prindërit dhe familjen ka qenë shumë e ngushtë. Përgjatë gjithë periudhës, por edhe përpara detyrimit ligjor për deklarimin e pasurisë në vitin 2004 (mars 2004, deklarata e parë), të ardhurat e mia kanë qenë të njësuara me ato të prindërve. Duke qenë një familje patriarkale dhe tradicionale, të ardhurat e mia janë dorëzuar kryesisht në familje, natyrisht duke përdorur nga këto të ardhura aq sa më nevojiteshin për shpenzime personale. Nisur nga fakti që të ardhurat nga paga dorëzoheshin në familje, duke mos u konceptuar si një dhuratë, por si një detyrim familjar, të ardhurat e mia janë përdorur për shpenzime familjare, por edhe për kursime të përdorura nga babai ynë. Në përgjigjet e mia në pyetësor për këtë arsye, nuk kam mundur të saktësoj një shumë të saktë dhënë prindërve të mi. Në deklarimet e mia përgjatë viteve 2004 – 2007 unë jam mundur të përllogaris një shumë të kursyer nga të ardhurat gjatë vitit, por nuk kam evidentuar pakësimin e tyre nga përdorimi nga babai në investimet në bono thesari apo në llogaritë bankare.*

*Shpjegoj që ky gabim, pasaktësi, përveç faktit të mostrajnit apo njohurive të duhura për plotësimin e deklaratave për deklarimin e pasurisë ka ardhur edhe për shkak të statusit tim social. Unë jam e ndarë nga familja në zyrën e gjendjes civile që nga viti 1993, por realisht unë kam jetuar dhe vazhdoj të jetoj me prindërit. Në deklaratën e parë të deklarimit të pasurisë, por edhe në ato periodike, detyrimi për deklarim është i anëtarëve të familjes, të cilët janë në certifikatën e gjendjes civile, madje edhe nëse prindërit do të kishin qenë në certifikatën e gjendjes civile nuk*

*ka qenë i parashikuar detyrimi i tyre për deklarim të pasurisë. Ky detyrim parashikohej për fëmijët madhorë me pasuri veçmas, bashkëshorti/ja e më pas edhe bashkëjetuesja. Për këtë arsye, nga ana ime nuk janë evidentuar edhe ndryshimet në lidhje me gjendjen cash. Duke mos mbajtur një evidencë të saktë, për shkak se të ardhurat dhe shpenzimet familjare ishin të përbashkëta (të miat dhe prindërve), edhe deklarimet e mia në vitet pas vitit 2007 në mungesë të një shifre të saktë, nuk kam deklaruar në lidhje me gjendjen cash”.*

### **Vlerësimi i Komisionit**

**2.19** Subjekti i rivlerësimit, në deklaratën *Vetting*, ka deklaruar shumat e tjera të kursyera deri në vitin 2015, dhënë prindërve (B dhe R.H), por nuk ka deklaruar vlerën e dhurimit.

**2.20** Subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar shumat e dhuruara prindërve në deklaratat periodike vjetore, por ka deklaruar gjendjet e kursimeve *cash* dhe ndryshimet e tyre deri në vitin 2007. Pas këtij viti nuk ka bërë asnjë deklarim tjetër lidhur me kursimet *cash*.

**2.21** Në përgjigje të pyetësorëve dhe të rezultateve të hetimit, subjekti ka deklaruar se gjendja *cash*, e krijuar ndër vite, ka qenë nga të ardhurat e gjithë familjes. Për këtë arsye, në analizën financiare janë trajtuar si kursime të të gjithë familjes dhe jo vetëm të subjektit.

**2.22** Subjekti përsëriti faktin se të ardhurat e saj kanë qenë të njësuara me ato të prindërve dhe se të ardhurat nga paga dorëzoheshin në familje duke mos u konceptuar si një dhuratë, por si një detyrim familjar.

**2.23** Kështu, subjekti nuk përcaktoi vlerën e saktë ose të përafërt që u ka dhënë prindërve dhe periudhën e saktë kur janë bërë këto dhurime.

**2.24** Subjekti ka bërë deklarim të pasaktë lidhur me kursimet *cash* dhe gjendjen e tyre në fund të viteve përkatëse. Subjekti nuk ka deklaruar shumat e dhuruara prindërve dhe ndryshimet e gjendjes *cash* në DPV-të periodike.

**2.25** Për sa më sipër, trupi gjykues arrin në përfundimin se deklarimi i subjektit është i pasaktë në lidhje me shumat e dhuruara prindërve.

### **3. Pasuri në përdorim të subjektit**

Subjekti nuk ka deklaruar në deklaratën *Vetting* pasuri të paluajtshme në pronësi apo përdorim.

a) Në deklaratën *Vetting* ka deklaruar si adresë banimi “\*\*\*”, Pukë.

b) Në deklaratat periodike, ndër vite, të dorëzuara në ILDKPKI, subjekti ka deklaruar si adresa banimi: (i) lagjja” \*\*\*”, Pukë; (ii) rruga “\*\*\*”, Tiranë (shtëpi e prindërve me vëllain dhe motrën).

### **Pasuri në qytetin e Pukës**

**3.1** ZVRPP-ja Pukë<sup>3</sup> konfirmon se shtetasja Flutura B. Hoxha nuk ka asnjë pasuri të paluajtshme, të regjistruar në emër të saj, në zonën e Pukës.

**3.2** Lidhur me prindërit e subjektit të rivlerësimit, shtetasit B.E.H dhe R.M.H, ZVRPP-ja Pukë ka konfirmuar se këta shtetas kanë dy pasuri të paluajtshme.

---

<sup>3</sup>Shihni përgjigjen e ZVRPP-së Pukë, dërguar me e-mail në dosjen e ILDKPKI-së.

**3.3** Pasuria e parë rezultoi një shtëpi banimi në lagjen “\*\*\*\*”. Kjo pasuri është pasuria e deklaruar nga subjekti si adresë banimi në deklaratën *Vetting*.

**3.4** Nga praktika e dërguar nga ZVRPP-ja Pukë, rezultoi se kjo pasuri është përfituar sipas vendimit të datës 17.1.1994 të gjykatës. Pasuria në fjalë nuk është regjistruar ende në sistemin e pasurive në ZVRPP-në Pukë. Sipas vendimit nr. \*\*\*, datë 17.1.1994, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pukë, është vendosur njohja e pronësisë së shtëpisë dykatëshe të ndërtuar në vitin 1982, në vlerën 1,009,239 lekë në fshatin \*\*\*, në emër të shtetasit B.H dhe bashkëshortes së tij (prindërit e subjektit).

**3.5** Për shkak se subjekti nuk ka deklaruar në deklaratën *Vetting* pasuri të paluajtshme në pronësi apo përdorim është pyetur se ku ka banuar dhe ku banon aktualisht dhe pse nuk e ka deklaruar pasurinë ku banon si pasuri në përdorim dhe burimin e krijimit (detyrim i parashikuar nga ligji nr. 84/2016).

**3.6** Në përgjigje të pyetësorit nr. \*\*\*, subjekti ka deklaruar: *“Sikurse e kam deklaruar edhe në pyetësin standard, kam përdorur dhe vazhdoj të jetoj në shtëpinë e prindërve në lagjen ‘\*\*\*’, Pukë. Kjo banesë është ndërtuar nga prindërit para viteve 1970 dhe është e pajisur me certifikatë pronësie nr. \*\*\*, datë 3.5.2019, lëshuar nga ZVRPP-ja Pukë, dërguar bashkëngjitur formularit standard. Ndërsa, pse nuk është deklaruar pasuria në përdorim në deklaratën *Vetting*, sqaroj se një deklaram i tillë është bërë dhe rikonfirmoj që pasuria në përdorim është shtëpia e prindërve me adresën lagjja ‘\*\*\*’, Pukë”*.

**3.7** Pasuria e dytë rezultoi një objekt ndërtesë në qytetin e Pukës, e regjistruar në sistemin e pasurive në ZVRPP-në Pukë, në datën 8.12.2014, me sipërfaqe totale 315 m<sup>2</sup>.

**3.8** Kartela e pasurisë së paluajtshme për këtë ndërtesë rezultoi në emër të shtetasit B.E.H (babai i subjektit).

**3.9** Bazuar në praktikën e përcjellë nga ZVRPP-ja Pukë, rezultoi se kjo pasuri është blerë me kontratë shitblerjeje të datës 4.12.1996, në degën e AKP-së Pukë me palë shitëse magazina e drithit Pukë dhe palë blerëse B.H, në vlerën 75,900 lekë.

### **Konkluzion i Komisionit**

➤ Subjekti nuk ka deklaruar pasurinë në përdorim, shtëpi dykatëshe, në lagjen “\*\*\*\*”, Pukë, në deklaratën *Vetting* dhe as burimin e krijimit të kësaj pasurie (detyrim ky i parashikuar nga ligji nr. 84/2016).

➤ Dy pasuritë e mësipërme në qytetin e Pukës janë përfituar dhe blerë nga prindërit e subjektit para fillimit të detyrës së saj si gjyqtare.

Në përgjigje të rezultateve të hetimit, subjekti deklaroi se: *“Për sa i përket shtëpisë së banimit në lagjen ‘\*\*\*’, Pukë, ku unë kam banuar qëkur kam lindur dhe ku vazhdoj të banoj dhe sot, me përjashtim të periudhave kur kam qenë me studime dhe punë në Tiranë, siç është shprehur edhe Komisioni, kjo shtëpi është ndërtuar përpara fillimit të detyrës sime si gjyqtare. Pronarë të ligjshëm të kësaj pasurie janë prindërit e mi. Gjithashtu, duhet sqaruar fakti që kjo shtëpi dykatëshe nuk është e gjitha në pronësi të prindërve të mi, por edhe të vëllezërve të babait. Prindërit e mi disponojnë vetëm një pjesë të katit të parë. Në pjesën tjetër të katit të parë banon familja e vëllait të babait, të ndjerit V.H, ndërsa kati i dytë është në pronësi të vëllait tjetër të babait, M.H.*

*Siç kam shpjeguar edhe në përgjigjet e pyetësorëve, babai im ka qenë me profesion topograf dhe pasi ka dalë në pension, por edhe përpara, ka bërë punime topografike për llogari të subjekteve të ndryshme private, ku është paguar në shuma të konsiderueshme. Punimet topografike të kryera dhe të ardhurat prej tyre janë detajuar në deklaratën e tij personale. Për shkak të kohës së gjatë kur janë kryer këto punime, mungesa e informacionit për vitet konkrete kur janë kryer projektet, ndryshimi apo shkrirja e institucioneve që kanë dhënë fondet, natyrës së tyre private, si dhe mospasjes detyrim për të mbajtur të dhëna apo fatura për pagesën për këto punime, pavarësisht përpjekjeve, nuk ka qenë e mundur të gjendet ndonjë dokumentacion provues. Shumica e të ardhurave nga këto punë janë kursyer nga babai. Gjithashtu, të gjithë anëtarët e familjes, qëkur kanë filluar marrëdhëniet e punës, kanë kontribuar rregullisht me të ardhura, të ardhura të cilat janë mbajtur dhe kursyer po nga babai”.*

### **Vlerësimi i Komisionit**

- Komisioni nuk konstatoi problematika lidhur me këtë pasuri dhe burimin e krijimit për shkak se është pasuri e krijuar nga babai i subjektit dhe vëllezërit e tij para fillimit të detyrës së subjektit si gjyqtare.
- Komisioni konstatoi se subjekti duhej ta kishte deklaruar si pasuri në përdorim në deklaratën *Vetting* dhe burimin e krijimit të kësaj pasurie.

### **4. Apartament në përdorim në vitet 2008 – 2012, në rrugën “\*\*\*\*”, Tiranë**

**4.1** Lidhur me deklarin e pasurisë apartament në rrugën “\*\*\*\*” Tiranë, i cili është deklaruar në pyetësorin standard si vendbanim për periudhën nëntor 2008 – dhjetor 2012, u kryen disa verifikime nga Komisioni.

**4.2** Verifikimet e kryera nga Komisioni për këtë pasuri u bazuan në:

- deklarimin e subjektit në përgjigje të pyetësorit se burimi për blerjen janë nga kontributi i të gjithë anëtarëve të familjes së saj dhe kontributi i subjektit nga të ardhurat e pagës;
- në DPV-të për vitet 2007 – 2012, ku kjo pasuri është deklaruar si adresë banimi;
- pikën 14, të nenit 3, të ligjit nr. 84/2016.

**4.3** Pika 14, e nenit 3, të ligjit nr. 84/2016 parashikon se: *“Persona të tjerë të lidhur janë personat fizikë apo juridikë që duket se kanë ose kanë pasur lidhje interesi me subjektin e rivlerësimit, që rrjedh nga një interes pasuror ose çdo marrëdhënie tjetër biznesi”.*

**4.4** Pra, Komisioni vlerëson se, në rastin konkret, subjekti i rivlerësimit ka pasur dhe ka lidhje interesi me pasurinë e paluajtshme në fjalë për shkak të përdorimit të kësaj pasurie dhe si bashkëkontribuuese për blerjen e saj.

**4.5** Subjekti nuk e ka deklaruar këtë pasuri, në përdorim apo si bashkëpronare (bashkëkontribuuese) e saj në deklaratën *Vetting*, kontributin financiar dhe as burimin e krijimit të saj.

**4.6** ZVRPP-ja Tiranë<sup>4</sup> konfirmon se në emrin e subjektit Flutura Hoxha dhe personave të lidhur me të nuk figurojnë pasuri të regjistruara në qytetin e Tiranës.

---

<sup>4</sup>Shihni përgjigjen e ZVRPP-së Tiranë me e-mail-in e datës 17.4.2019, në dosjen e ILDKPKI-së.

**4.7** Subjekti është pyetur<sup>5</sup> për këtë pasuri apartament në qytetin e Tiranës, ku i kërkohet pse nuk është deklaruar si pasuri në përdorim, pse nuk janë deklaruar pronarët e saj, burimi i krijimit të kësaj pasurie, lidhja e saj me këtë pasuri, si dhe investimet dhe shpenzimet e kryera prej saj, si dhe mund të sqarohet pse nuk e ka deklaruar këtë pasuri në përdorim edhe në deklaratën *Vetting*.

**4.8** Gjithashtu, Komisioni i kërkoi subjektit që të provonte me dokumentacion shkresor se kush është pronari i kësaj pasurie, burimin e ligjshëm për blerjen e saj, vitin/vitet e pagesave të kryera për blerjen e saj, si dhe kontributin financiar në këtë pasuri, duke vënë në dispozicion një kopje të kontratës së shitblerjes së kësaj pasurie dhe dokumentacionin për regjistrimin në regjistrin e pasurive të paluajtshme.

**4.9** Në përgjigje të pyetësorit nr. \*\*\*, subjekti ka deklaruar<sup>6</sup>: *“Pasuria apartament me adresë: rruga ‘\*\*\*’, e deklaruar në përdorim në deklaratat periodike është i njëjti apartament me adresë rruga ‘\*\*\*’, nd. \*\*\*, h. \*\*\*, ap. \*\*\*, i cili është deklaruar në pyetësorin standard si vendbanim për periudhën nëntor 2008 – dhjetor 2012. Në momentin kur është bërë deklarata periodike nuk ka qenë i vendosur sistemi i adresave, prandaj i jam referuar adresës së përcaktuar në kontratën e porosisë, si dhe lejes së dalë për ndërtimin e objektit ku ndodhej apartamenti i deklaruar. Apartamenti me adresë rruga ‘\*\*\*’, nd. \*\*\*, h. \*\*\*, ap. \*\*\*, është porositur me kontratë porosie nr. \*\*\* rep., datë 17. 9.2007, nga babai B.H. Burimi i të ardhurave janë kursimet e prindërve B dhe R.H, të ardhurat nga puna e babait në sektorin privat, si dhe kontributi i të gjithë pjesëtarëve të tjerë të familjes, vëllait tim S.H dhe motrës time A.H, si dhe kontributi im nga të ardhurat e pagës.*

*Porositësi i kësaj pasurie është babai im B.H (sikurse deklaruar në pyetësorin standard, ku bashkëngjitur është dërguar edhe kontrata e porosisë, datë 17.9.2007 dhe se ende nuk është bërë regjistrimi pranë regjistrin të pasurive të paluajtshme)”*.

**4.10** Gjithashtu, në përgjigje të pyetësorit nr. \*\*\*, pyetjes së bërë subjektit për të sqaruar blerjen e kësaj pasurie që ka pasur në përdorim si dhe të provojë burimin e ligjshëm për blerjen e saj, subjekti i rivlerësimit deklaroi se: *“Apartamenti me adresë rruga ‘\*\*\*’, nd. \*\*\*, h. \*\*\*, ap. \*\*\*, është porositur nëpërmjet kontratës së porosisë nga babai B.H në vlerën 63,250 euro. Pagesa e çmimit të apartamentit është kryer e ndarë në dy këste, respektivisht, kësti i parë në shumën 28,070 euro dhe kësti i dytë në shumën 35,180 euro. Burimi i të ardhurave janë kursimet ndër vite të prindërve B dhe R.H, të ardhurat nga puna e babait në sektorin privat si topograf me projektimin e rrugëve, ujësjellësve, objekteve, saktësime hartash, planimetrisht dhe punime të tjera topografike, të cilat kanë qenë me porositës Bashkia Pukë, Instituti i tokave, Bashkia Fushë-Arrëz, Ndërmarrja e Ujësjellësit Pukë, Ujësjellësit Fushë-Arrëz etj., por pagesat janë kryer cash nga subjektet private, të cilët kanë kryer punimet sipas projekteve respektive, mandatet e të cilave babai nuk i disponon, si dhe kontributi i të gjithë pjesëtarëve të tjerë të familjes, vëllait tim S.H dhe motrës time A.H, si dhe kontributi im nga të ardhurat e pagës. Konkretisht:*

*Kësti i parë – vlera prej 28,070 euro që përbën këstin e parë sipas kontratës së porosisë, e likuiduar në datën 17.9.2007, vjen nga të ardhurat sikurse është sqaruar më lart. Vlera rreth 1,000,000 lekë, pjesë e pagesës së këstit të parë është marrë hua nga babai im, B.H te miku i tij i ngushtë, i ndjeri R.M, për të cilin nuk është lidhur asnjë deklaratë huaje, pasi kjo vlerë do të*

<sup>5</sup>Shihni pyetësorin nr. \*\*\*, dërguar nga Komisioni.

<sup>6</sup>Shihni përgjigjen e dërguar nga subjekti mbi pyetësorin nr. \*\*\* në dosjen e Komisionit.

*kthehej në një kohë të shkurtër, në kushtet që babai e dispononte të investuar në formën e bonove të thesarit, e cila u thye në dhjetor 2007, kohë në të cilën është kthyer edhe huaja.*

*Kësti i dytë – vlera prej 35,180 euro buron nga veprimet e kryera si më poshtë:*

*i. Në datën 19.12.2007 është thyer bonoja e thesarit në vlerën 1,600,000 lekë, nga ku 11,486 lekë është mbajtur tatim në maturim dhe vlera neto e bonos është 1,588,514 lekë, transferuar nëpërmjet urdhrimit të transfertës së Bankës së Shqipërisë më 24.12.2007, nga llogaria escrow \*\*\*, në llogarinë rrjedhëse pranë 'Raiffeisen Bank' nr. \*\*\*, në emër të vëllait tim S.H.*

*ii. Në datën 21.11.2007 është thyer bonoja e thesarit në vlerën 500,000 lekë, nga ku 3,498 lekë është mbajtur tatim në maturim dhe vlera neto e bonos është 496,502 lekë.*

*iii. Në datën 19.12.2007, është thyer bonoja e thesarit në vlerën 3,130,000 lekë, nga ku 22,469 lekë është mbajtur tatim në maturim dhe vlera neto e bonos së bashku me vlerën 496,502 lekë të bono thesarit, cituar në pikën ii) më lart, total vlera është 3,604,033 lekë, transferuar nëpërmjet urdhrimit të transfertës së Bankës së Shqipërisë më 24.12.2007, nga llogaria escrow \*\*\* në llogarinë rrjedhëse në 'Raiffeisen Bank' nr. \*\*\*, në emër të vëllait tim S.H.*

*Totali i bonove të listuar më sipër shkon në vlerën 5,192,547 lekë, nga të cilat është bërë pagesa e kështit të dytë të shtëpisë në vlerën 4,220,000 lekë, në datën 26.12.2007, sipas urdhrimit të transfertës në 'Raiffeisen Bank', urdhëruar nga vëllai im S.H. Referuar publikimeve për kursin e këmbimit në faqen zyrtare të Bankës së Shqipërisë rezulton që kursi i lekut kundrejt euros, në një mesatare ditore në datën 26.12.2007 ka qenë 120,41, e cila përbën vlerën në euro të kështit të dytë në shumën 35,180 euro, sikurse parashikohet në kontratën e porosisë. Diferenca në lekë, pas konvertimit të vlerës totale 5,192,547 lekë për pagesën e kështit të dytë, rezulton në vlerën e përafërt 1,000,000 lekë, e cila është përdorur për të shlyer huan e marrë ndaj të ndjerit R.M, sikurse është sqaruar më lart”.*

**4.11** Pas kësaj përgjigjeje, për një sqarim të mëtejshëm, subjekti u pyet përsëri nga Komisioni nëse mund të vërtetonte me dokumentacion provues ligjor:

- mundësinë e blerjes së apartamentit në rrugën “\*\*\*\*”, Tiranë, nga babai, vëllai dhe motra e saj;
- mundësinë financiare të z. R.M, si huadhënës te babai në vlerën 1,000,000 lekë;
- si dhe burimin e ligjshëm të krijimit të bonove të thesarit në emër të babait dhe vëllait të saj.

**4.12** Subjekti, në përgjigje të pyetësorit nr. \*\*\*, ka shpjeguar se: “Sikurse e kam shpjeguar edhe në pyetësorin nr. \*\*\*, të ardhurat për blerjen e kësaj pasurie vijnë nga kursimet ndër vite të prindërve B dhe R. H, të ardhurat nga puna e babait në sektorin privat si topograf, si dhe kontributi nga të ardhurat e pagës sime, të ardhurat e pagës së vëllait, i ndjeri S.H dhe pagës së motrës, A.H. Pagesa për blerjen e kësaj pasurie është bërë në dy këste:

*Kësti i parë - vlera 3,500,000 lekë, e konvertuar në 28,070 euro, likuiduar sipas mandatarkëtimit nr.\*\*\*, datë 17.9.2007. Vlera 2,500,000 lekë e pagesës së këtij kësti ka si burim të ardhurat nga paga për vitet 2006 - 2007, sipas vlerave të tërhequra nga llogaria rrjedhëse, të ardhurat e babait, B.H, sipas tabelës 2, të ardhurat nga paga si mësuese të nënës, R.H, të ardhurat si punonjës policie të vëllait, i ndjeri S.H, si dhe nga të ardhurat e motrës, A.H. Ndërsa, diferenca prej 1,000,000 lekësh, e pagesës së këtij kësti, është marrë hua nga miku i ngushtë i babait, i ndjeri z. R.M.*

*Kësti i dytë - vlera 4,220,000 lekë e konvertuar në 35,180 euro, është krijuar nga thyerja e bonove të thesarit në emër të babait B.H dhe vëllait S.H, sikurse është sqaruar në pikën 5, të pyetësorit nr. \*\*\*.*

*Në vitin 2005, babai B.H ka investuar në bono thesari, në Bankën e Shqipërisë, vlerën 3,630,000 lekë, ndërsa vëllai, i ndjeri S.H vlerën 1,940,000 lekë. Në total, vlera e investuar në bono thesari është 5,570,000 lekë. Kjo vlerë ka si burim: kursimet cash në vlerën 1,300,000 lekë, të deklaruara në deklaratat periodike deri në vitin 2005, të kontribuara në familje; të ardhurat nga paga ime sipas vlerave të tërhequra nga llogaria rrjedhëse në vitin 2005; të ardhurat e babait B.H, sipas tabelës 2; të ardhurat nga paga si mësuese të nënës, R.H; të ardhurat si punonjës policie të vëllait S.H, si dhe vlera 250,000 lekë është kontribuar nga të ardhurat si ushtarake të motrës, A.H”.*

**4.13** Në përgjigje të pyetësorit subjekti ka sjellë në mënyrë përmbledhëse edhe të ardhurat e pretenduara si vijojnë.

**Tabela nr. 1 – FLUTURA HOXHA**

Vitet	Të ardhura nga paga dhe shpërblime të tjera
2003	680,288
2004	906,400
2005	1,028,599
2006	1,050,966
2007	1,153,268.13
<b>Totali</b>	<b>4,819,521.13</b>

**Tabela nr. 2 – B.H**

Të ardhura	Vitet 1998 – 2007
Nga punët në sektorin privat	2,885,000
Nga pensioni	1,334,438
Nga pension invaliditeti	400,000
Dëmshpërblim për aksident automobilistik	371,743
Interesa nga investimi në bono thesari	473,312
<b>Totali</b>	<b>5,464,493</b>

**4.14** Subjekti, gjithashtu, ka deklaruar se z. R.M ka ndërruar jetë në vitin 2019, sipas certifikatës së vdekjes bashkëlidhur. Nga deklarimi i babait rezulton se z. R.M e ka pasur shumën gjendje në bankë, të krijuar nga të ardhurat nga emigracioni të fëmijëve të tij, kurse burim për krijimin e bonove të thesarit janë kursimet, ndër vite, të prindërve B dhe R.H, të ardhurat nga puna e babait në sektorin privat si topograf, si dhe kontributi nga të ardhurat e pagës së subjektit, të ardhurat e pagës së vëllait S.H dhe pagës së motrës A.H.

**4.15** Për të provuar mundësitë për blerjen e apartamentit nga familjarët, është pyetur subjekti që të provojë me dokumentacion justifikues ligjor burimin e ligjshëm të investimeve në bono thesari, të bëra nga babai i subjektit B.H në vlerat:

- 500,000 lekë në datën 11.10.2005;
- 3,130,000 lekë në datën 20.12.2005;
- 2,166,357 lekë në datën 25.8.2016;

• 295,230 lekë në datën 22.9 2016.

**4.16** Subjekti, në përgjigje të pyetësorit nr. \*\*\*, ka shpjeguar se: *“Sikurse kam shpjeguar edhe në pyetësorët e mëparshëm, investimet e bëra nga babai B.H, në Bankën e Shqipërisë janë krijuar nga kursimet, ndër vite, nga paga dhe pensionet e prindërve B dhe R.H; nga të ardhurat e krijuara nga puna e babait në sektorin privat; nga interesat bankare; nga kontributi nga të ardhurat nga paga ime; kontributi nga paga e vëllait, të ndjerit S.H dhe kontributi nga të ardhurat nga paga e motrës A.H. Sipas shpjegimeve të babait, një pjesë e derdhjeve/depozitave të mësipërme janë krijuar si rezultat i lëvizjeve bankare për shkak të interesave. Bashkëlidhur, dokumentacioni provues për të ardhurat nga paga të pjesëtarëve të familjes, sipas viteve”*.

**4.17** Komisioni hartoi analizën financiare për mundësinë e blerjes së apartamentit në rrugën “\*\*\*”, në emër të babait të subjektit, nga subjekti dhe familjarët e tjerë të saj.

Në analizën financiare të hartuar nga Komisioni përfshihen të ardhurat e subjektit deri në dhjetor të vitit 2007. Në këtë analizë janë marrë parasysh të ardhurat e babait të subjektit, z. B.H, nga pensioni i pleqërisë (vitet 1998 – 2007), si dhe nga dëmshpërblimi për aksident nga shoqëria “\*\*\*”, sipas vendimit nr.\*\*\*, datë 22.10.1999, të gjykatës.

Gjithashtu, janë marrë parasysh të ardhurat nga puna e nënës, vëllait dhe motrës së subjektit deri në dhjetor të vitit 2007.

Në analizën financiare nuk janë marrë parasysh të ardhurat nga huaja e pretenduar nga i ndjeri R.M, për arsye se subjekti nuk arriti të provojë burimin e ligjshëm të huadhënies nga ana e këtij të fundit.

**4.18** Nga analiza financiare rezulton se subjekti dhe familjarët e saj nuk kishin mjaftueshëm burime të ligjshme për blerjen e apartamentit, kryerjen e investimeve të tjera dhe mbulimin e shpenzimeve të periudhës në një vlerë prej 2,354,100 lekësh.

**Në përfundim të hetimit, Komisioni i kaloi barrën e provës subjektit të rivlerësimit lidhur me apartamentin në rrugën “\*\*\*”, Tiranë.**

➤ Kjo pasuri është porositur me kontratë porosie nga babai i subjektit dhe nuk është regjistruar në regjistrin e pasurive të paluajtshme. Për blerjen e saj, subjekti ka deklaruar se kanë kontribuar prindërit e saj, vëllai dhe motra, si dhe ajo vetë, gjë që për Komisionin përbën interes pasuror mbi këtë pasuri.

➤ Subjekti është shkëputur nga trangu familjar më 10.8.1993, por në përgjigje të pyetësorëve ka deklaruar se ka banuar me prindërit gjatë gjithë periudhës, si dhe me pjesëtarët e tjerë, motrën dhe vëllain, për periudha të kufizuara kohore. Për këtë arsye, në analizë financiare janë përfshirë të ardhurat dhe shpenzimet e të gjithë anëtarëve të familjes sipas deklaramit të subjektit.

➤ Subjekti deklaroi në pyetësorin standard se ka banuar në këtë apartament (banesë në përdorim) përgjatë viteve 2008 – 2012, kohë kur ka punuar si inspektore pranë ish KLD-së, Tiranë.

➤ Kjo pasuri është blerë dhe përdorur me qëllim përdorimin dhe strehimin e subjektit gjatë periudhës së ushtrimit të detyrës së inspektores pranë ish Inspektoratit të KLD-së.

➤ Subjekti nuk ka deklaruar në deklaratat periodike dhe as në deklaratën *Vetting* se sa ka qenë vlera e kontribuar prej saj për blerjen e kësaj pasurie.



➤ Subjekti ka bërë deklarin të pasaktë dhe të paplotë në lidhje me këtë pasuri duke u përpjekur ta fshehtë atë, si dhe burimin e krijimit.

➤ Komisioni ka kryer analizën e mundësisë së blerjes së këtij apartamenti nga subjekti dhe nga familjarët e saj, ku ka rezultuar pamjaftueshmëri financiare për blerjen e këtij apartamenti në vitin 2007. Subjekti duket se ka pasur një pamundësi financiare prej në vlerën 2,354,100 lekë, për blerjen e kësaj pasurie.

**4.19** Për sa më sipër, subjektit të rivlerësimit i kaloi barra e provës për të dhënë argumente dhe paraqitur provat për të provuar të kundërtën e konstatimeve të bëra nga Komisioni, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016.

### **Qëndrimi i subjektit**

**4.20** Në përgjigje të rezultateve të hetimit, subjekti deklaroi se: *“Sqaroj se kjo pasuri është porositur nëpërmjet kontratës së porosisë nga babai B.H në vlerën 63,250 euro. Pagesa e çmimit të apartamentit është kryer e ndarë në dy këste, respektivisht, kësti i parë në shumën 28,070 euro dhe kësti i dytë në shumën 35,180 euro. Ashtu siç kam deklaruar, për këtë pasuri kanë investuar të gjithë anëtarët e familjes. Burimi i të ardhurave kanë qenë kursimet ndër vite të prindërve B dhe R.H, të ardhurat nga puna e babait në sektorin privat si topograf me projektimin e rrugëve, ujësjellësve, objekteve, saktësime hartash, planimetrish dhe punime të tjera topografike, të cilat kanë qenë me porositës Bashkia Pukë, Instituti i tokave, Bashkia Fushë-Arrëz, Ndërmarrja e Ujësjellësit Pukë, Ujësjellësit Fushë-Arrëz etj., por pagesat janë kryer cash nga subjektet private, të cilat kanë kryer punimet sipas projekteve respektive, mandatet e të cilave babai nuk i disponon, si dhe kontributi i të gjithë pjesëtarëve të tjerë të familjes, vëllait tim S.H dhe motrës sime A.H, si dhe kontributi im nga të ardhurat e pagës.*

*Lidhur me pagesat e kryera kam shpjeguar që:*

*Kësti i parë – vlera prej 28,070 euro që përbën këstin e parë sipas kontratës së porosisë, e likuiduar në datën 17.9.2007, vjen nga të ardhurat sikurse është sqaruar më lart. Vlera rreth 1,000,000 lekë, pjesë e pagesës së këstit të parë është marrë hua nga babai im B.H te miku i tij i ngushtë i ndjeri R.M, për të cilin nuk është lidhur asnjë deklaratë huaje, pasi kjo vlerë do të kthehej në një kohë të shkurtër, në kushtet që babai e dispononte të investuar në formën e bonove të thesarit, e cila u thye në dhjetor 2007, kohë në të cilën është kthyer edhe huaja.*

*Kësti i dytë – vlera prej 35,180 euro buron nga veprimet e kryera si vijojnë:*

*i. Në datën 19.12.2007 është thyer bonoja e thesarit në vlerën 1,600,000 lekë, nga ku 11,486 lekë është mbajtur tatim në maturim dhe vlera neto e bonos është 1,588,514 lekë, transferuar nëpërmjet urdhrin të transfertës së Bankës së Shqipërisë më 24.12.2007, nga llogaria escrow \*\*\*, në llogarinë rrjedhëse në ‘Raiffeisen Bank’ nr. \*\*\*, në emër të vëllait tim S.H.*

*ii. Në datën 21.11.2007 është thyer bonoja e thesarit në vlerën 500,000 lekë, nga ku 3,498 lekë është mbajtur tatim në maturim dhe vlera neto e bonos është 496,502 lekë.*

*iii. Në datën 19.12.2007 është thyer bonoja e thesarit në vlerën 3,130,000 lekë, nga ku 22,469 lekë është mbajtur tatim në maturim dhe vlera neto e bonos së bashku me vlerën 496,502 lekë të bonos së thesarit, cituar në pikën ii) më lart, total vlera është 3,604,033 lekë, transferuar nëpërmjet urdhrin të transfertës së Bankës së Shqipërisë më 24.12.2007, nga llogaria escrow \*\*\* në llogarinë rrjedhëse në ‘Raiffeisen Bank’ nr. \*\*\*, në emër të vëllait tim S.H.*

*Totali i bonove të listuar më sipër shkon në vlerën 5,192,547 lekë, nga të cilat është bërë pagesa e këstit të dytë të shtëpisë në vlerën 4,220,000 lekë, në datën 26.12.2007, sipas urdhrit të transfertës në 'Raiffeisen Bank', urdhëruar nga vëllai im S.H. Referuar publikimeve për kursin e këmbimit në faqen zyrtare të Bankës së Shqipërisë rezultojnë që kursi i lekut kundrejt euros, në një mesatare ditore në datën 26.12.2007 ka qenë 120,41, e cila përbën vlerën në euro të këstit të dytë në shumën 35,180 euro, sikurse parashikohet në kontratën e porosisë. Diferenca në lekë pas konvertimit të vlerës totale 5,192,547 lekë për pagesën e këstit të dytë, rezultojnë në vlerën e përafërt 1,000,000 lekë, e cila është përdorur për të shlyer huan e marrë ndaj të ndjerit R.M, sikurse është sqaruar më lart.*

*Për sa i përket huadhënies nga miku i babait, jam përpjekur të siguroj informacionin e nevojshëm për të ardhurat e tij dhe familjarëve të tij, por në kushtet që ai ka ndërruar jetë dhe bashkëshortja dhe disa nga fëmijët e tij jetojnë jashtë vendit për mua ka qenë i pamundur sigurimi i këtij informacioni. Në Shqipëri jeton vetëm vajza e tij nga e cila kam siguruar deklaratën noteriale nr. \*\*\* rep., datë 9.2.2022, bashkëlidhur këtyre prapësimeve.*

*Në këto rrethana, në pamundësi objektive do të kërkoja që të kihet në konsideratë parashikimi ligjor në nenin 32/2 të ligjit nr. 84/2016.*

*Analiza juaj financiare ka një pasaktësi, e cila e çon në përfundime të gabuara. Sipas analizës suaj financiare të kryer për apartamentin, në fund të vitit 2002 rezultojnë një diferencë pozitive në shumën 2,235,381 lekë. Kjo gjendje pozitive nuk është marrë në konsideratë nga ana juaj. Gjithashtu, në vitin 2003, nga analiza e dokumentuar e kryer nga ana juaj rezultojnë një gjendje pozitive në shumën 645,601 lekë, e cila gjithashtu nuk përfshihet dhe nuk merret në konsideratë për faktin se nuk është deklaruar në DPV-në e vitit 2003.*

*Kujtoj që në deklaratën e parë, të kryer në mars të vitit 2004 për arsye që shpjegova më lart, e ndarë nga trangu familjar dhe në certifikatën familjare jam vetëm unë, deklarimi im është jo i plotë duke mos evidentuar dhe saktësuar apo sqaruar që kursimet e mia janë të përbashkëta me ato të familjes. Analiza juaj financiare si për apartamentin, por edhe ajo totale përfundimtare ka përfshirë edhe anëtarët e tjerë të familjes. Ju keni gjykuar që në kushtet kur subjekti ka deklaruar se kanë kontribuar prindërit e saj, vëllai dhe motra, si dhe ajo vetë, për Komisionin përbën interes pasuror mbi këtë pasuri. Por, kryerja e kësaj analize financiare sipas kësaj metodologjie do të duhej të merrte në konsideratë realisht të ardhurat dhe shpenzimet e familjarëve të mi dhe jo të referohej vetëm në deklaratat e mia periodike. Pasi nëse do të referohej vetëm deklarimeve të mia periodike, natyrisht në kushtet kur unë nuk zotëroj pasuri të paluajtshme apo të luajtshme, e gjithë situata financiare do të rezultonte me gjendje pozitive madje dhe të konsiderueshme.*

*Në analizën tuaj financiare evidentohen dhe bëhen pjesë të analizës sime edhe ndryshimet në gjendjet e llogarive bankare të babait tim, pavarësisht se nuk evidentohen kursimet, ndër vite, të konstatuara edhe nga ana juaj që në vitin 2002, në shumën 2,235,381 lekë. Kjo e deformon totalisht analizën financiare, duke sjellë një rezultat të gabuar financiar<sup>7</sup>”.*

**4.21** Subjekti, në përgjigjet e rezultateve të hetimit, ka paraqitur disa analiza financiare ku pasqyron pretendimet lidhur me mundësitë për blerjen e apartamentit në rrugën “\*\*\*\*” në vitin

---

<sup>7</sup>Shihni komentet e subjektit për analizën financiare në përgjigje të rezultateve të hetimit.

2007, si dhe analizën financiare totale të pretenduar prej saj për periudhën 1996 – 2016. Në këto analiza, subjekti pretendon se përfshihen të ardhurat dhe kursimet e të gjithë familjes<sup>8</sup>.

**4.22** Subjekti, në shpjegimet e saj përfundimtare në përgjigje të rezultateve të hetimit, pretendoi se në analizën financiare duhen përfshirë të ardhurat më të larta nga puna e saj, e vëllait të saj të ndjerë dhe babait të saj. Vetëm ato të ardhura që u vërtetuan me dokumentacion janë përfshirë në analizën financiare.

**4.23** Subjekti pretendon se rezultati pozitiv i nxjerrë për periudhën 1996 – 2002 te rezultatet e hetimit në vlerën 2,235,381 lekë ka qenë gjendje *cash* në fund të vitit 2002 dhe ka shërbyer si burim për investimet e babait të subjektit në depozitat e krijuara në vitet 2004 dhe 2005. Meqë subjekti pretendon se kjo vlerë ishte gjendje në fund të vitit 2002, kjo gjë u pasqyrua nga Komisioni në analizën financiare, duke e përfshirë atë si kursime *cash* në rubrikën e pasurisë në këtë vit. Nga ana tjetër, nga Komisioni kjo vlerë (2,235,381 lekë) e pretenduar nga subjekti nuk mund të konsiderohet si gjendje në fund të vitit 2003 për shkak të mosdeklarimit të kursimeve *cash* në deklaratën e atij viti. Si rrjedhim, kjo vlerë nuk u konsiderua si burim për krijimin e depozitave dhe llogarive të tjera në vitet 2004 – 2005, nga babai i subjektit.

**4.24** Subjekti, në seancën dëgjimore, u pyet se çfarë përfaqësonin kursimet *cash* të deklaruara në vitet 2004 – 2007 dhe, në përgjigjen e saj, deklaroi se ato përfaqësonin kursimet e të gjithë familjes. Bazuar në këtë deklaratë të subjektit, në analizën financiare të periudhës 1996 – 2007, Komisioni përllogariti kursimet e deklaruara në DPV si kursime të të gjithë familjes. Si rrjedhim, ndryshe nga rezultatet e hetimit, rezultati total i analizës së mundësisë së blerjes së apartamentit mbledh vetëm rezultatet negative të këtyre viteve dhe jo më rezultatet pozitive. Kjo për faktin se Komisioni vlerësoi se rezultatet e viteve pozitive nuk mund të mbarten si kursime tek viti pasardhës përderisa nuk janë deklaruar si gjendje *cash* në fund të vitit.

**4.25** Subjekti, në përgjigje të rezultateve të hetimit, pretendoi se duhen përfshirë në analizën financiare edhe të ardhurat nga interesi nga bonot e thesarit, në të cilat kanë investuar babai dhe vëllai i saj i ndjerë. Nga analiza financiare nuk vërtetohet mundësia financiare për krijimin e këtyre bonove të thesarit në vitin 2005 nga babai i saj në vlerën 3,630,000 lekë dhe nga vëllai i ndjerë në vlerën 1,600,000 lekë. Për këtë arsye, as të ardhurat e gjeneruara nga këto bono thesari nuk u konsideruan si burim i ligjshëm për blerjen e një pasurie tjetër.

#### **4.26 Analiza financiare e blerjes së apartamentit në rrugën “\*\*\*”, Tiranë**

---

<sup>8</sup>Shihni përgjigjen e subjektit mbi rezultatet e hetimit.

<b>Analiza e mundesise se blerjes se apartamentit ne Rr. *** - 2007</b>							
<b>Pershkrimi</b>	<b>1996 - 2002</b>	<b>2003</b>	<b>2004</b>	<b>2005</b>	<b>2006</b>	<b>2007</b>	<b>TOTAL</b>
<b>PASURI</b>	<b>2,235,381</b>	<b>-2,235,381</b>	<b>2,523,944</b>	<b>2,524,640</b>	<b>620,661</b>	<b>4,435,714</b>	<b>7,720,000</b>
Apartamet 90,36 m2 - 63,250€ - 2007 - B.H. & R. H.						7,720,000	7,720,000
Ndryshim likuiditeti ne banke			1,923,944	1,824,640	20,661	-3,384,286	
<b>Ndryshim likuiditeti ne kursimet cash</b>	<b>2,235,381</b>	<b>-2,235,381</b>	<b>600,000</b>	<b>700,000</b>	<b>600,000</b>	<b>100,000</b>	
<b>DETYRIME</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>0</b>
<b>PASURI NETO (PASURI - DETYRIME)</b>	<b>2,235,381</b>	<b>-2,235,381</b>	<b>2,523,944</b>	<b>2,524,640</b>	<b>620,661</b>	<b>4,435,714</b>	<b>7,720,000</b>
<b>TE ARDHURA dokumentuar</b>	<b>4,664,154</b>	<b>1,115,421</b>	<b>1,571,797</b>	<b>2,091,442</b>	<b>2,342,621</b>	<b>2,569,875</b>	<b>14,355,310</b>
Te ardhura subjekti Flutura Hoxha	2,321,738	695,279	911,662	1,001,700	982,121	1,141,473	7,053,973
Te ardhura babai i subjektit B. H. nga pensioni dhe demshperblim	900,967	146,862	157,434	168,614	191,310	213,444	1,778,631
Te ardhura motra e subjektit A. H.		31,486	281,885	330,427	342,008	377,310	1,363,116
Te ardhura vellai i subjektit S. H.	435,230			344,402	528,049	523,467	1,831,147
Te ardhura nena e subjektit R.H. nga puna dhe pensioni	1,006,219	241,794	220,816	246,299	299,134	314,181	2,328,443
<b>SHPENZIME</b>	<b>2,428,772</b>	<b>469,820</b>	<b>469,820</b>	<b>547,785</b>	<b>547,785</b>	<b>989,100</b>	<b>5,453,082</b>
Shpenzime jetese 5 persona	2,428,772	469,820	469,820	547,785	547,785	683,100	5,147,082
Shpenzime qiraje Tirane						270,000	270,000
Shpenzuar motra e subjektit per qendrim tek Hoteli i SHUT - 2007						36,000	36,000
<b>Analiza dokumentuar</b>	<b>0</b>	<b>2,880,982</b>	<b>-1,421,967</b>	<b>-980,983</b>	<b>1,174,175</b>	<b>-2,854,939</b>	<b>-5,257,890</b>

➤ Nga analiza financiare rezulton se subjekti dhe familjarët e saj kishin një pamundësi totale financiare prej 5,257,890 lekësh për blerjen e apartamentit në rrugën “\*\*\*”, për bërjen e investimeve të tjera dhe për mbulimin e të gjitha shpenzimeve të periudhës 1996 – 2007.

## Vlerësimi i Komisionit

- Subjekti nuk ka deklaruar përdorimin e këtij apartament dhe burimet e krijimit në deklaratën *Vetting*.
- Subjekti, gjatë hetimit, nuk ka deklaruar qartë burimin e krijimit të këtij apartamenti duke mos përcaktuar pjesën e saj takuese në vlerë monetare.
- Ka marrëdhënie të pandërprerë me përdorimin e këtij apartamenti që nga momenti i blerjes, kohë kur subjekti ka ushtruar detyrën e inspektore në KLD;
- Prindërit jetojnë në Pukë dhe e përdorin vetëm në rastet kur vijnë bashkë me subjektin në Tiranë.
- Subjekti nuk përcaktoi qartë kontributin e saj në këtë pasuri.
- Subjekti dhe familja e saj kanë mungesë të burimeve të ligjshme në shumën 5,257,890 lekë.

Trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit ka ndërmarrë veprime të tilla si vendosja e këtij apartamenti në emër të babait të saj, si person i cili nuk ishte i lidhur me subjektin (pasi nga gjendja civile vërtetohet se subjekti nuk është në certifikatë familjare me babain) dhe, si i tillë, nuk është i detyruar të deklarojë pasurinë, me qëllim fshehjen e kësaj pasurie.

Mosdeklarimi i përdorimit të kësaj pasurie nga subjekti në deklaratën *Vetting* sipas kërkesave të ligjit nr. 84/2016, është bërë me qëllimin e vetëm për t'u mos evidentuar dhe deklaruar në ILDKPKI, sepse kjo pasuri sipas edhe konkluzionit të Komisionit është krijuar nga burime të paligjshme nga subjekti dhe personat e tjerë të lidhur, sipas pikës 14, të nenit 3, të ligjit nr. 84/2016. Në të kundërt, subjekti, nëse e kishte nga burime të ligjshme do të duhet ta kishte deklaruar në deklaratën *Vetting*.

Subjekti ka bërë deklaram të pasaktë, të pamjaftueshëm dhe ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar blerjen e pasurisë apartament në rrugën “Jordan Misja”, duke u gjendur në kushtet e përcaktuara në gerrat “a” dhe “b”, të pikës 5, të nenit 33, të ligjit nr. 84/2016.

Gjithashtu, Komisioni vlerëson se subjekti i rivlerësimit gjendet në kushtet e pikës 5, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës dhe gerrës “c”, të nenit 33, të ligjit nr. 84/2016.

## Konstatime të tjera

**5.** Nga verifikimi i të dhënave bankare të babait të subjektit u evidentuan disa depozita dhe derdhje bankare në “Raiffeisen Bank” dhe “Intesa Sanpaolo Bank” si vijojnë:

- depozitë në “Raiffeisen Bank”, që vjen me një tepricë me vlerë 1,341,894 lekë, në datën 30.9.2004;
- depozitë në “Raiffeisen Bank”, që vjen nga një tepricë me vlerë 919,637 lekë, në datën 25.2.2005;
- derdhje në llogari në “Raiffeisen Bank” të vlerës 2,786,122 lekë në datën 7.12.2005;
- derdhje në depozitë në “Raiffeisen Bank” të vlerës 5,800 USD, në datën 5.9.2005;
- derdhje në llogari në “Raiffeisen Bank” të vlerës 340,000 lekë, në datën 17.1.2007;
- derdhje në llogari në “Raiffeisen Bank” të vlerës 1,000,000 lekë, në datën 7.6.2011;
- depozitë në “Intesa Sanpaolo Bank” në vlerën 1,400,000 lekë, në datën 12.6.2012 dhe shtesave të tjera në këtë depozitë nga derdhje të mëvonshme.

**5.1** Për këtë u pyet subjekti që të mund të vërtetonte me dokumentacion justifikues ligjor burimin e ligjshëm të këtyre depozitave dhe derdhjeve të babait B.H.

**5.2** Subjekti, në përgjigje të pyetësorit nr. \*\*\*, ka shpjeguar se: “*Sikurse kam shpjeguar edhe në pyetësorët e mëparshëm, të gjitha depozitat dhe derdhjet e bëra nga babai B.H në bankat e mësipërme, janë krijuar: nga kursimet ndër vite, nga paga dhe pensionet e prindërve B dhe R.H;*

nga të ardhurat e krijuara nga puna e babait në sektorin privat; nga interesat bankare; nga kontributi nga të ardhurat nga paga ime; kontributi nga paga e vëllait, të ndjerit S.H dhe kontributi nga të ardhurat nga paga të motrës, A.H. Sipas shpjegimeve të babait, një pjesë e derdhjeve/depozitave të mësipërme janë krijuar si rezultat i lëvizjeve ndërmjet bankave për shkak të interesave, për të cilat po kërkohet informacion në bankat e mësipërme. Ndërsa, për sa i përket të ardhurave nga puna e babait si topograf po kërkohet informacion në institucionet ku janë kryer projektet dhe do të dërgohet sapo të na vihet në dispozicion. Në bazë të vërtetimeve të të ardhurave nga paga dhe të ardhurave të tjera të anëtarëve të familjes rezulton se kanë qenë të mjaftueshme për blerjen e apartamentit në rrugën '\*\*\*', Tiranë.

*Bashkëlidhur dokumentacioni provues për të ardhurat nga paga të pjesëtarëve të familjes, sipas viteve”.*

Këto depozita janë bërë pjesë e analizës financiare me gjendjen e tyre në fund të çdo viti respektiv.

Për depozitën në “Raiffeisen Bank”, që vjen me një tepricë me vlerë 1,341,894 lekë, në datën 30.9.2004 dhe depozitën në “Raiffeisen Bank”, që vjen nga një tepricë me vlerë 919,637 lekë në datën 25.2.2005, informacioni bankar që vjen në lidhje me këto dy depozita nuk qartëson momentin e saktë të krijimit të tyre.

Subjekti duhet të provojë periudhën e krijimit të këtyre depozitave, si dhe burimin e ligjshëm të krijimit të tyre.

**6.** Nga verifikimi i të dhënave bankare të babait të subjektit, u evidentua një depozitë bankare pranë ish Bankës Amerikane, në vlerën 6,000 USD.

**6.1** Për këtë, subjektit iu kërkua të vërtetonte me dokumentacion justifikues ligjor burimin e ligjshëm të kësaj depozite, e krijuar në vitin 2004 në vlerën 6,000 USD nga babai B.H, si dhe të deklaronte kur është tërhequr kjo vlerë parash nga babai i saj.

**6.2** Subjekti, në përgjigje të pyetësorit nr. \*\*\*, ka shpjeguar se: “Sipas shpjegimeve të babait, shuma e mësipërme e depozituar në ish Bankën Amerikane, rrjedh nga vlera e projekteve të realizuara nga babai B.H, për llogari të Fondit Shqiptar të Zhvillimit dhe Institutit të Pronave, sikurse janë detajuar në deklaratën noteriale, për të cilat po vazhdojmë të kërkojmë dokumentacion provues dhe do të dërgohet sapo të na vihet në dispozicion”.

**6.3** Sipas statementit të ish Bankës Amerikane, në emër të babait të subjektit B.H figuron një depozitë e krijuar në shtator të vitit 2004. Sipas dokumentacionit në dhjetor të vitit 2004, kjo depozitë maturohet në vlerën 6,009,32 USD. Nuk është e qartë nëse kjo depozitë tërhiqet në fund të vitit apo lihet gjendje.

**6.4** Në analizën financiare kjo vlerë prej 6,009,32 USD është lënë gjendje në fund të vitit 2004.

**6.5** Në përfundim të hetimit, Komisioni i kaloi barrën e provës subjektit për të vërtetuar dhe provuar me dokumentacion justifikues ligjor burimin e ligjshëm të krijimit të këtyre depozitave dhe derdhjeje në llogari bankare.

### **Qëndrimi i subjektit**

**6.6** Në përgjigje të rezultateve të hetimit, subjekti ka deklaruar se: “Për sa i përket këtij konstatimi shpjegoj që ashtu siç kam thënë edhe në pyetësor burimi i tyre është: nga kursimet ndër vite, nga paga dhe pensionet e prindërve B dhe R.H; nga të ardhurat e krijuara nga puna e babait në sektorin privat; nga interesat bankare; nga kontributi nga të ardhurat nga paga ime; kontributi nga paga e vëllait, të ndjerit S.H, dhe kontributi nga të ardhurat nga paga e motrës, A.H.

*Nga analiza juaj financiare e kryer për apartamentin, por edhe ajo totale rezulton një diferencë pozitive në fund të vitit 2002, në shumën 1,800,000 lekë ose 2,235,381 lekë. Kjo diferencë pozitive është e mjaftueshme për të shpjeguar edhe depozitimet e kryera nga babai në ‘Raiffeisen Bank’*

dhe 'Intesa Sanpaolo Bank', pa marrë në konsideratë të ardhurat dhe kursimet familjare të viteve 2003, 2004 dhe 2005.

Sipas analizës së kryer nga ana ime dhe shpjegimeve të dhëna më sipër lidhur me apartamentin, gjendja cash në fund të vitit 2002, pas korrektimit të të ardhurave të mia dhe të vëllait sipas dokumentacionit të dorëzuar ka qenë në shumën 2,543,938 lekë. Kjo shumë justifikon plotësisht depozitimet e përmendura nga ju më sipër”.

### **Vlerësimi i Komisionit**

- Subjekti nuk arriti të provonte me dokumentacion justifikues ligjor mundësinë e krijimit të këtyre depozitave dhe derdhjeve në llogaritë bankare.
- Subjekti ka bërë deklaram të pamjaftueshëm lidhur me këto likuiditete.

### **7. Apartament në pronësi të babait të subjektit B.H, në rrugën “\*\*\*\*”, Tiranë**

**7.1** Nga faqja zyrtare e ASHK-së është evidentuar pasuria apartament nr. \*\*\*\*, kulla \*\*\*\*, nr. \*\*\*\*, rruga “\*\*\*\*”, me sip. 62.6 m<sup>2</sup>, në emër të babait të subjektit B.H.

**7.2** Për këtë fakt të evidentuar, por nisur edhe nga një denoncim i mbërritur në Komision për subjektin e rivlerësimit, subjektit iu kërkua të vërtetonte me dokumentacion ligjor vitin, vlerën dhe burimin e krijimit të blerjes së këtij apartamenti. Gjithashtu, subjektit iu kërkua të deklaronte nëse kishte kontribuar për blerjen e këtij apartamenti dhe, nëse po, sa ka qenë vlera dhe burimi i kontributit të tij sipas viteve përkatëse.

**7.3** Subjekti në përgjigje të pyetësorit nr. \*\*\*\*, ka shpjeguar se apartamenti i mësipërm është blerë në vitin 2017 nga babai B.H në vlerën 37,500 euro. Burim i të ardhurave për blerjen e këtij apartament janë: kursimet nga të ardhurat nga puna; pensioni i pleqërisë dhe i invaliditetit të babait të subjektit B.H; të ardhurat nga paga dhe pensioni i nënës R.H; të ardhurat nga paga e vëllait, i ndjeri S.H; si dhe të ardhurat nga paga e motrës, A.H. Me kontratë dhurimi, nr. \*\*\*\* rep., datë 8.12.2021, apartamenti i mësipërm u është dhuruar fëmijëve të vëllait, të ndjerit S.H. Subjekti nuk ka kontribuar për blerjen e këtij apartamenti.

**7.4** Bashkëlidhur subjekti ka paraqitur: vërtetim për bazën e vlerësueshme dhe pagën *neto* mesatare, për periudhën 1996 – 2007, për nënën R.H; vërtetim nr. \*\*\*\* prot., datë 23.11.2021, për trajtimin me pension pleqërie, për nënën R.H; vërtetim për bazën e vlerësueshme, për periudhat 2000 – 2002, 2005 – 2006 dhe 2012 – 2015, për vëllain S.H; vërtetim nr. \*\*\*\* prot., datë 23.12.2021, për vjetërsi në punë dhe trajtim financiar për vëllain S.H; vërtetim për bazën e vlerësueshme dhe pagën *neto* mesatare për periudhën 2003 – 2013, për motrën A.H; vërtetim nr. \*\*\*\* prot., datë 17.12.2021, për trajtim me strehim, i motrës A. H; si dhe kontratë dhurimi nr. \*\*\*\* rep., datë 8.12.2021.

**7.5** Duke parë mundësitë financiare të familjarëve të subjektit për blerjen e këtij apartamenti në rrugën “\*\*\*\*”, Tiranë, por edhe faktin se shpjegimet e subjektit, si në përgjigjet e pyetësorëve të mëparshëm, nuk kanë qenë të plota dhe bindëse, Komisioni i kërkoi subjektit sqarime lidhur me këtë pasuri dhe burimin e krijimit dhe kontributin e saj. Subjekti në përgjigje të rezultateve paraqiti shpjegimet e saj lidhur me burimin e pasurisë<sup>9</sup>.

### **Konkluzion i Komisionit**

**7.6** Komisioni konstatoi se përgjigjet e subjektit ishin bindëse për sa i përket kësaj pasurie. Kjo pasuri është përfituar dhe regjistruar në fillim në emër të babait të subjektit të rivlerësimit pas plotësimit të deklaratës *Vetting*. Më pas prindërit e subjektit ia kanë dhuruar këtë apartament fëmijëve të të ndjerit (vëllait të subjektit). Në këto kushte nuk u provua që kjo pasuri është e subjektit apo të ketë ndonjë të drejtë reale mbi të ose të ketë kontribuar për blerjen e saj. Në

<sup>9</sup> Shiko përgjigjet e subjektit mbi rezultatet e hetimit

përfundim, Komisioni arriti në konkluzionin se kjo pasuri nuk rrjedh nga ndonjë interes pasuror për subjektin e rivlerësimit.

## **8. Analiza financiare**

**8.1** Nga analiza financiare, e hartuar nga Komisioni, rezultoi se subjekti dhe familjarët e saj kanë një pamundësi financiare totale në vlerën 6,173,859 lekë.

**8.2** Për sa më sipër, subjektit të rivlerësimit iu la barrë prove për të dhënë argumente dhe paraqitur prova për të provuar të kundërtën e konstatimeve të bëra nga Komisioni bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016.

### **Qëndrimi i subjekti**

**8.3** Në përgjigje të rezultateve të hetimit, subjekti ka paraqitur analizën e kryer nga një ekspert i fushës, duke korrigjuar mangësitë në analizën financiare. Sipas subjektit kjo analizë shpjegon dhe sqaron të gjithë situatën dhe burimet e mundshme financiare për çdo depozitim apo investim të kryer prej saj dhe familjarëve. Gjithashtu, analiza financiare e mëposhtme, sipas subjektit, evidenton dhe korrigjon si vijon:

- të ardhurat e papërfshira në vitin 1998 në shumën 119,793 lekë;
- të ardhurat e papërfshira të të vëllait, i punësuar pranë Drejtorisë Vendore Shkodër, në shumën 1,053,809 lekë dhe në Drejtorinë Vendore të Policisë Lezhë, në shumën 7,846,119 lekë;
- të ardhurat nga interesat e bonove të thesarit, investuar nga babai dhe vëllai;
- pasqyrim të saktë në likuiditete të gjendjes cash së babait, duke përfshirë të ardhurat e familjes.

*Për këtë arsye, gjendja e likuiditeteve të disponuara nga babai është saktësuar referuar të ardhurave të siguruara, për të cilat sqarohet se, në gjendjen e tij të likuiditeteve janë shtuar likuiditetet nga të ardhurat e siguruara nga familjarët, por, gjithashtu, gjendjet janë pakësuar në rastin e investimeve apo depozitimeve të kryera prej tij. Ky pasqyrim sjell në mënyrë të saktë likuiditetet e zotëruara prej tij (të detajuara këto i gjeni në analizën financiare në excel në rubrikën “likuiditete”). Nga analiza financiare e kryer rezulton mëse e mundshme me burime të ligjshme blerja e apartamentit në vitin 2007. Ky apartament është blerë në kushtet dhe me burimin e të ardhurave të të gjithë familjarëve kur unë dhe motra banonim në një apartament me qira, në Tiranë*

**8.4** Komisioni vlerësoi se analiza financiare e periudhës 1996 – 2007 për subjektin është e njëjtë me analizën e mundësisë së blerjes së apartamentit në rrugën “\*\*\*”<sup>10</sup>. Ky vlerësim u bazua në deklaratën e subjektit për ndarje të të ardhurave, kursimeve dhe shpenzimeve me familjarët e saj, deri në blerjen e këtij apartamenti në vitin 2007. Kjo analizë rezultoi me një pamundësi totale financiare në vlerën 5,257,890 lekë.

---

<sup>10</sup>Shihni analizën financiare në pikën 4.27 të vendimit.



## 8.5 Analiza financiare për periudhën 2008 – 2016

SUBJEKTI I RIVLERESIMIT: FLUTURA B. HOXHA										
PERSHKRIMI	2008	2009	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016	TOTAL
<b>PASURI</b>	<b>-545,961</b>	<b>319,432</b>	<b>-105,022</b>	<b>955,885</b>	<b>329,767</b>	<b>648,655</b>	<b>-38,168</b>	<b>469,621</b>	<b>995,532</b>	<b>0</b>
Apartamet 90,36 m2 - 63,250€ - 2007 - B.H. & R. H.										0
Ndryshim likuiditeti ne banke	-545,961	319,432	-105,022	955,885	329,767	648,655	-38,168	469,621	995,532	
<b>Ndryshim likuiditeti ne kursimet cash</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>0</b>
<b>DETYRIME</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>0</b>
<b>PASURI NETO (PASURI - DETYRIME)</b>	<b>-545,961</b>	<b>319,432</b>	<b>-105,022</b>	<b>955,885</b>	<b>329,767</b>	<b>648,655</b>	<b>-38,168</b>	<b>469,621</b>	<b>995,532</b>	<b>0</b>
<b>TE ARDHURA dokumentuar</b>	<b>1,795,229</b>	<b>2,046,880</b>	<b>1,995,479</b>	<b>2,061,318</b>	<b>2,112,015</b>	<b>1,686,962</b>	<b>1,960,570</b>	<b>2,046,966</b>	<b>1,995,180</b>	<b>17,700,599</b>
Te ardhura subjekti Flutura Hoxha	1,196,246	1,323,012	1,064,139	1,103,057	1,070,688	1,167,646	1,421,286	1,512,549	1,430,869	11,289,492
Te ardhura babai i subjektit B. H. nga pensioni	177,498	195,248	203,922	211,842	220,080	227,920	236,906	240,902	248,357	1,962,675
Te ardhura motra e subjektit A. H.	421,485	443,420	466,826	475,639	539,901					2,347,271
Te ardhura nena e subjektit R. H. nga puna dhe pensioni	0	85,200	260,592	270,780	281,346	291,396	302,378	293,515	315,954	2,101,161
<b>SHPENZIME</b>	<b>1,118,980</b>	<b>818,980</b>	<b>546,480</b>	<b>547,172</b>	<b>558,192</b>	<b>423,072</b>	<b>660,695</b>	<b>762,163</b>	<b>705,276</b>	<b>6,141,009</b>
Shpenzime jetese	546,480	546,480	546,480	546,480	558,192	423,072	659,994	672,828	705,276	5,205,282
Shpenzime qiraje Tirane	300,000									300,000
Shpenzime mobilimi	272,500	272,500								545,000
Shpenzime udhetimi	0	0	0	692	0	0	701	89,335	0	90,727
<b>Analiza dokumentuar</b>	<b>1,222,210</b>	<b>908,468</b>	<b>1,554,021</b>	<b>558,262</b>	<b>1,224,056</b>	<b>615,235</b>	<b>1,338,044</b>	<b>815,182</b>	<b>294,372</b>	<b>8,529,849</b>
							<b>Pamundesi totale financiare</b>			<b>0</b>

8.6 Nga analiza financiare, për periudhën 2008 – 2016, nuk rezulton ndonjë pamundësi financiare.

8.7 Në total, pamundësia financiare për subjektin dhe familjarët e saj, për periudhën 1996 – 2016, rezulton në vlerën 5,257,890 lekë.

## 9. Metodologjia e përdorur nga Komisioni për analizën financiare

Gjatë kësaj analize, Komisioni është bazuar në:

a. Gjendjet e likuiditeteve të subjektit dhe personave të lidhur të nxjerra nga dokumentet bankare të kërkuara nga bankat e nivelit të dytë: “Raiffeisen Bank”, “Intesa Sanpaolo Bank”, Banka e Shqipërisë, si dhe gjendjet *cash* të deklaruara nga subjekti.

b. Të ardhurat e ligjshme, ku përfshihen:

i) Të ardhurat nga pagat e subjektit në: Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Pukë (1998 – 2007) dhe (2012 – 2016), Këshillin e Lartë të Drejtësisë (2007 – 2012).

ii) Të ardhurat nga pagat e babait të subjektit B.H nga pensioni i pleqërisë (1998 – 2016), pensioni i invaliditetit (1 korrik 2006 – 2016), sipas vërtetimit nr. \*\*\* prot., datë 2.2.2022 dhe veprimeve të pasqyruara në llogarinë bankare në “Raiffeisen Bank”, në emër të babait, si dhe të ardhurat nga shpërblimi për aksident nga shoqëria \*\*\* (1999).

iii) Të ardhurat e nënës së subjektit të rivlerësimit R.H nga puna në Njësinë Administrative Pukë (1996 – 2007), si dhe të ardhurat nga pensioni (2009 – 2016).

iv) Të ardhurat nga paga të vëllait të subjektit, të ndjerit S.H, në Komisaratin e Policisë Tropojë (2000 – 2002), në Drejtorinë Vendore të Policisë Tiranë (2005), në Drejtorinë Vendore të Policisë Kukës (2005 – 2006), si dhe në Drejtorinë Vendore të Policisë Lezhë (2006 – 2007).

v) Të ardhurat nga paga të motrës së subjektit A.H në Repartin Ushtarak nr. \*\*\* Tiranë (2003 – 2004), në Forcat e Armatosura (2004 – 2008), si dhe në Repartin Ushtarak nr. \*\*\* Tiranë (2009 – 2013).

c. Shpenzimet, ku përfshihen:

i) Shpenzimet e jetesës bazuar në shpenzimet mujore për konsum sipas përbërjes familjare (anketa e buxhetit të familjes nga INSTAT).

Shpenzimet e jetesës, për periudhën 1996 – 2007, janë llogaritur për 5 persona, duke përfshirë të gjithë anëtarët e familjes (subjektin, prindërit, vëllain dhe motrën).

ii) Shpenzime udhëtimi për të cilat janë marrë të dhëna nga sistemi *TIMS*. Për përlllogaritjen e shpenzimeve të udhëtimit është zbatuar vendimi nr. 11/2019 (JR.), datë 22.5.2015, i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit. Nuk janë marrë në konsideratë shpenzimet e udhëtimit kur subjekti/ bashkëshorti kanë deklaruar e dokumentuar udhëtime për qëllime pune dhe ato për të cilat janë dokumentuar qëndrimi pranë të afërmeve.

iii) Shpenzime mobilimi të deklaruara nga subjekti (2008 - 2009) në përgjigje të pyetësorit.

iv) Shpenzime qiraje të subjektit, për periudhën 2007 – 2008, në Tiranë, të deklaruara në përgjigje të pyetësorit.

ç. Në vlerat e pasurive të luajtshme dhe të paluajtshme, bazuar në kontratat e sipërmarrjeve/ shitblerjeve të këtyre pasurive<sup>[1]</sup>.

---

<sup>[1]</sup> Shihni kontratat e shitjeve për pasuritë e paluajtshme, në dosjen e ILDKPKI-së dhe të Komisionit.

## B. KONTROLLI I FIGURËS

**Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (DSIK)** ka kryer kontrollin e figurës së subjekti të rivlerësimit, me anë të verifikimit të deklarimeve dhe të dhënave të tjera, me qëllim që të identifikohet nëse subjekti i rivlerësimit ka kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës dhe në ligjin nr. 84/2016.

Për këtë qëllim, DSIK-ja ka dërguar një raport për subjektin e rivlerësimit, në përputhje me nenin 39 të ligjit nr. 84/2016. Sipas këtij raporti, subjekti i rivlerësimit ka plotësuar saktë dhe me vërtetësi formularin e deklarimit për kontrollin e figurës, si dhe nuk ka informacione se subjekti ka kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar.

Si konkluzion, DSIK-ja ka konstatuar *përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës të subjektit të rivlerësimit Flutura Hoxha*.

Komisioni, si organ i legjitimuar nga Kushtetuta dhe ligji nr. 84/2016, për të bërë rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë, ka hetuar në mënyrë të pavarur çdo informacion dhe konkluzion të institucionit të sipërpërmendur ashtu sikurse të gjitha faktet dhe informacionet e marra nga çdo subjekt i së drejtës, në përputhje me nenet 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016.

Në përfundim të rivlerësimit për kriterin e kontrollit të figurës, Komisionit i rezulton se subjekti i rivlerësimit Flutura Hoxha, arrin nivel të besueshëm në kontrollin e figurës, sipas parashikimit germës “b”, të nenit 59/1, të ligjit nr. 84/2016, pasi nga verifikimet e kryera nuk rezultoi se ka kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar, ka dorëzuar në kohë deklaratën për figurën, si dhe nuk ka bërë deklarime të pasakta dhe nuk ka fshehur kontakte me persona të përfshirë në krimin e organizuar.

## C. VLERËSIMI I AFTËSIVE PROFESIONALE

Raporti për vlerësimin profesional është përgatitur bazuar në ligjin nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” dhe në ligjin nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, duke referuar kriteret e mëposhtme të vlerësimit:

- a) aftësitë profesionale;
- b) aftësitë organizative;
- c) etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale; dhe
- ç) aftësitë personale dhe angazhimi profesional.

Ky raport është hartuar bazuar në përshkrimin dhe analizimin e: (i) formularit të vetëdeklarimit, të 3 dokumenteve ligjore të përzgjedhura nga vetë subjekti i rivlerësimit, si dhe të dhënave e dokumenteve të tjera që shoqërojnë formularin e vetëdeklarimit dhe që janë paraqitur nga vetë subjekti i rivlerësimit; (ii) pesë dosje gjyqësore, të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor; (iii) të dhënat nga burimet arkivore të KLD-së.

### **Formulari i vetëdeklarimit dhe dokumentet e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit**

Formulari është paraqitur nga subjekti dhe plotësuar sipas shtojcës së ligjit nr. 84/2016.

Subjekti i rivlerësimit Flutura Hoxha: në periudhën 8.5.1998 – 5.3.2007, ka ushtruar detyrën e gjyqtarës pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pukë; në periudhën 5.3.2007 – 15.11.2012, ka

ushtruar detyrën e inspektores në Këshillin e Lartë të Drejtësisë; si dhe për periudhën 16.11.2012 dhe në vazhdim ushtron detyrën e gjyqtares në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Pukë.

Subjekti i rivlerësimit Flutura Hoxha ka deklaruar se tri vitet e fundit të ushtrimit të detyrës i janë caktuar për shqyrtim gjithsej 779 çështje dhe ka përfunduar me vendim përfundimtar 665 çështje, si dhe ka mbartur për vitin e fundit të ushtrimit të detyrës gjithsej 20 çështje.

Subjekti i rivlerësimit Flutura Hoxha ka deklaruar në formular se ka qenë pjesëmarrëse në 7 trajnime të organizuara nga Shkolla e Magjistraturës, që i përkasin periudhës së rivlerësimit.

Gjatë periudhës së rivlerësimit, subjekti i rivlerësimit Flutura Hoxha ka përzgjedhur dhe paraqitur tri dokumente ligjore të llojit vendim gjyqësor. Një prej këtyre vendimeve është dhënë nga subjekti në vitin 2014, një tjetër në vitin 2015, ndërsa një vendim është i vitit 2016. Këto vendime përshkruhen si vijon:

**Dokumenti 1:** vendimi gjyqësor penal nr. \*\*\*, datë 10.7.2014, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pukë, që i përket Prokurorisë së Rrethit Pukë Gjyqësor Pukë kundër të pandehurve A.P, S.P, B.P dhe F.S.P, të akuzuar për veprat penale të “vrasje në rrethana të tjera cilësuese kundër dy personave, në bashkëpunim”, “vrasje në rrethana të tjera cilësuese, në mënyrë të rrezikshme për jetën e shumë personave, në tentativë dhe në bashkëpunim” dhe “mbajtje pa leje të armëve luftarake”, të parashikuara nga nenet 79/dh-25, 79/ë-22-25 dhe 278/2 të Kodit Penal.

**Dokumenti 2:** vendimi gjyqësor penal nr. \*\*\*, datë 3.6.2015, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pukë, që i përket Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Pukë kundër të pandehurit S.B, i akuzuar për veprën penale të shpërdorimit të kontributeve të dhëna nga shteti, të parashikuar nga neni 256 i Kodit Penal, si dhe kundër të pandehurës, shoqërisë “\*\*\*\*” sh.p.k., e akuzuar për veprën penale “shpërdorim të kontributeve të dhëna nga shteti”, të parashikuar nga neni 256 i Kodit Penal dhe nenet 3, 9 dhe 11/4, germa “c” dhe vijues të ligjit nr. 9754/2007 “Për përgjegjësinë penale të personave juridikë”.

**Dokumenti 3:** vendimi gjyqësor penal nr. \*\*\* datë 19.5.2016, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pukë, që i përket Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Pukë, kundër të pandehurës T.L, e akuzuar për veprën penale të “mashtrimi në sigurime”, të parashikuar nga neni 145 i Kodit Penal.

### **Përshkrimi i pesë dosjeve gjyqësore për gjyqtaren Flutura Hoxha të përzgjedhura me short**

**Dosja 1** - çështja penale nr. \*\*\*, datë 6.3.2014 regj., që i përket Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Pukë, kundër të pandehurit B.M, i akuzuar për veprën penale “drejtim të automjeteve në mënyrë të parregullt”, të parashikuar nga neni 291 i Kodit Penal, e përfunduar me vendimin nr. \*\*\*, datë 1.4.2014.

Çështja me shortin elektronik të datës 6.3.2014, i ka kaluar për gjykim gjyqtares Flutura Hoxha, e cila më 6.3.2014, me vendim ka caktuar seancën gjyqësore në datën 21.3.2014, ora 11:00.

Gjykimi i çështjes është realizuar në intervalin kohor 6.3.2014 – 1.4.2014, duke zgjatur 26 ditë, dhe duke respektuar afatin standard 9-mujor të parashikuar nga germa “a”, pika 5, e Aneksit 1 të Sistemit të Vlerësimit. Rrjedhimisht, është respektuar standardi për një proces të rregullt ligjor i parashikuar nga neni 42 i Kushtetutës dhe neni 6 i KEDNj-së.

Dosja gjyqësore dhe vendimi gjyqësor nr. \*\*\*, datë 1.4.2014, janë dorëzuar në kryesekretarinë e gjykatës në datën 5.4.2014, 4 ditë nga shpallja, duke respektuar afatin 5-ditor të përcaktuar nga neni 113 i Kodit të Procedurës Penale.

Vendimi gjyqësor nr. \*\*\*, datë 1.4.2014, është dhënë nga subjekti i rivlerësimit në cilësinë e gjyqtarit të vetëm. Vendimi përmban elementët e përcaktuar nga neni 383 i Kodit të Procedurës Penale dhe është i ndarë në pjesën hyrëse, pjesën përshkruese-arsyetuese dhe në dispozitivin e

gjykatës dhe paraqitet me strukturë të qëndrueshme. Vendimi i mësipërm ka marrë formë të prerë pa u ankimuar nga palët.

**Dosja 2** - çështja penale nr. \*\*\*, datë 12.3.2015 regj., që i përket Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Pukë kundër të pandehurit D.B, i akuzuar për veprën penale “vjedhje të energjisë elektrike”, të parashikuar nga neni 137/1 i Kodit Penal, përfunduar me vendimin nr. \*\*\*, datë 9.4.2015.

Çështja me shortin elektronik të datë 12.3.2015, i është caktuar gjyqtarës Flutura Hoxha, e cila në datën 12.3.2015, me vendim, caktoi seancën gjyqësore më 26.3.2015, ora 10:00. Nxjerrja e vendimit dhe caktimi i datës së seancës ka respektuar afatet 10-ditore të përcaktuara nga neni 333 të Kodit të Procedurës Penale.

Gjykimi i çështjes nga subjekti i rivlerësimit ka zgjatur 28 ditë, në intervalin kohor 12.3.2015 – 9.4.2015. Kohëzgjatja e gjykimit është brenda afatit standard 9-mujor të përcaktuar nga germa “a”, pika 5, e Aneksit 1 të Sistemit të Vlerësimit. Rrjedhimisht, është respektuar standardi për një proces të rregullt ligjor të parashikuar nga neni 42 i Kushtetutës dhe neni 6 i KEDNj-së.

Dosja gjyqësore dhe vendimi përfundimtar është dorëzuar në sekretarinë e gjykatës në datë 14.4.2015, 5 ditë pas shpalljes, brenda afatit 5-ditor të parashikuar nga neni 113 i Kodit të Procedurës Penale.

Vendimi gjyqësor nr. \*\*\*, datë 9.4.2015, është dhënë nga gjyqtarja Flutura Hoxha, në cilësinë e gjyqtarit të vetëm, i cili përmban elementët e parashikuar nga neni 383 i Kodit të Procedurës Penale dhe është i ndarë në pjesën hyrëse, pjesën përshkruese-arsyetuese dhe në dispozitivin e gjykatës dhe paraqitet me strukturë të qëndrueshme. Vendimi ka marrë formë të prerë pa u ankimuar nga palët.

**Dosja 3** - çështja civile nr. \*\*\*, datë 3.5.2016 regj., që i përket paditëses Sh.Xh kundër të paditurës Zyra e Gjendjes Civile pranë Bashkisë Pukë, me objekt “deklarimin e pavlefshëm të aktit të lindjes lidhur me vendin e lindjes”, e përfunduar me vendimin nr. \*\*\*, datë 19.9.2016.

Çështja me shortin elektronik të datës 3.5.2016, i ka kaluar për shqyrtim gjyqtarës Flutura Hoxha, e cila me vendimin e datës 4.5.2016, caktoi seancën përgatitore më 11.5.2016, ora 13:00.

Gjykimi i çështjes nga subjekti i rivlerësimit ka zgjatur gjithsej 4 muaj e 16 ditë (1 muaj përfshin lejen vjetore), në intervalin kohor 3.5.2016 – 19.9.2016. Kohëzgjatja e gjykimit është brenda afatit standard 6-mujor të përcaktuar nga germa “e”, pika 5, e Aneksit 1 të Sistemit të Vlerësimit. Rrjedhimisht, është respektuar standardi për një proces të rregullt ligjor të parashikuar nga neni 42 i Kushtetutës dhe neni 6 i KEDNj-së.

Dosja gjyqësore dhe vendimi përfundimtar është dorëzuar në sekretarinë e gjykatës në datën 30.9.2016, 11 ditë pas shpalljes, duke tejkaluar me 1 ditë afatin 10-ditor të parashikuar nga neni 308 i Kodit të Procedurës Civile.

Vendimi gjyqësor nr. \*\*\*, datë 19.9.2016, është dhënë nga gjyqtarja Flutura Hoxha, në cilësinë e gjyqtarës së vetme. Vendimi përmban elementët e nenit 310 Kodit të Procedurës Civile dhe është i ndarë në pjesën hyrëse, pjesën përshkruese-arsyetuese dhe në dispozitivin e gjykatës dhe paraqitet me strukturë të qëndrueshme. Vendimi ka marrë formë të prerë pa u ankimuar.

**Dosja 4** - çështja civile nr. \*\*\*, datë 28.1.2016 regj., që i përket paditëses H.F kundër të paditurit DRSSH-së Shkodër, me objekt “konstatimin e pasaktësisë së pjesshme të regjistrit themeltar të ish-kooperativës Bujqësore K, fshati B, për sa i përket gjeneraliteteve dhe vërtetimin e faktit juridik të marrëdhënies së punës, për periudhën 1.1.1990 – 19.7.1991, duke realizuar mesataren e ditëve të punës të kërkuar për gratë”, e përfunduar me vendimin përfundimtar nr. \*\*\*, datë 31.3.2016.

Çështja me shortin elektronik të datës 28.1.2016, iu caktua gjyqtarës Flutura Hoxha, e cila me vendimin e datës 1.2.2016, caktoi seancën përgatitore më 8.2.2016, ora 11:30.

Gjykimi i çështjes nga subjekti i rivlerësimit ka zgjatur 2 muaj e 3 ditë, në intervalin kohor 28.1.2016 – 31.3.2016. Konstatohet se gjykimi ka respektuar afatin standard 6-mujor, të përcaktuar germa “e”, pika 5, e Aneksit 1 të Sistemit të Rivlerësimit. Rrjedhimisht, është respektuar standardi për një proces të rregullt ligjor i parashikuar nga neni 42 i Kushtetutës dhe neni 6 i KEDNj-së.

Dosja gjyqësore dhe vendimi gjyqësor nr. \*\*\*, datë 31.3.2016, janë dorëzuar në sekretarinë gjyqësore të Gjykatës së Rrethit Pukë në datën 15.4.2016, 15 ditë nga shpallja, tej afatit 10-ditor të parashikuar nga neni 308 paragrafi i dytë i Kodit të Procedurës Civile.

Vendimi gjyqësor nr. \*\*\*, datë 31.3.2016, është dhënë nga gjyqtarja Flutura Hoxha, në cilësinë e gjyqtarës së vetme. Vendimi përmban elementët e nenit 310 të Kodit të Procedurës Civile dhe është i ndarë në pjesën hyrëse, pjesën përshkruese-arsyetuese dhe në dispozitivin e gjykatës dhe paraqitet me strukturë të qëndrueshme.

Vendimi i mësipërm u kundërshtua nga pala e paditur për në Gjykatën e Apelit Shkodër, duke kërkuar rrëzimin e padisë së paditëses. Gjykata e Apelit Shkodër, me vendimin nr. \*\*\*, datë 20.10.2016, për shkak të heqjes dorë nga ankimi i bërë nga pala e paditur, ka vendosur pushimin e shqyrtimit të çështjes civile prej saj.

**Dosja 5** - çështja familjare nr. \*\*\*, datë 21.4.2014 regj., që i përket paditëses F.T kundër të paditurit A.D, me objekt “zgjidhje martesë”, e përfunduar me vendimin përfundimtar nr. \*\*\*, datë 24.6.2014.

Çështja me shortin elektronik të datës 21.4.2014, iu caktua gjyqtarës Flutura Hoxha, e cila me vendimin e datës 21.4.2014, caktoi seancën e pajtimit më 6.5.2014, ora 13:00.

Gjykimi i çështjes nga subjekti i rivlerësimit ka zgjatur 2 muaj e 3 ditë, në intervalin kohor 21.4.2014 – 24.6.2014. Konstatohet se gjykimi ka respektuar afatin standard 4-mujor të përcaktuar nga germa “d”, pika 5, e Aneksit 1 të Sistemit të Rivlerësimit. Rrjedhimisht, nuk është cenuar standardi për një proces të rregullt ligjor i parashikuar nga neni 42 i Kushtetutës dhe neni 6 i KEDNj-së.

Dosja gjyqësore dhe vendimi gjyqësor u dorëzuan në sekretarinë gjyqësore të Gjykatës së Rrethit Pukë në datën 3.7.2014, brenda 9 ditëve nga shpallja, në respektim të afatit 10-ditor të parashikuar nga neni 308, paragrafi i dytë, i Kodit të Procedurës Civile.

Vendimi gjyqësor nr. \*\*\*, datë 24.6.2014, është dhënë nga gjyqtarja Flutura Hoxha, në cilësinë e gjyqtarit të vetëm. Vendimi përmban elementët e kërkuar nga neni 310 i Kodit të Procedurës Civile dhe është i ndarë në pjesën hyrëse, pjesën përshkruese-arsyetuese dhe në dispozitivin e gjykatës dhe paraqitet me strukturë të qëndrueshme. Ky vendim ka marrë formë të prerë pa u ankimuar nga palët ndërgjyqëse.

## **ANALIZA E GJETJEVE**

Nga analiza e të dhënave në dosjen personale, konstatohet se gjyqtarja Flutura Hoxha ka marrë titullin “jurist” nga Universiteti i Tiranës në datën 26.6.1996. Në datën 9.5.1998 është emëruar gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Pukë. Më pas, në nëntor 1998 emërohet edhe kryetare e kësaj gjykate deri më 5.3.2007, kur është emëruar inspektore në Inspektoratin e KLD-së. Pas përfundimit të mandatit të inspektore në datën 15.11.2012, është rikthyer në detyrën e gjyqtarës në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Pukë. Në vijim, në datën 16.7.2015 delegohet për të kryer përkohësisht detyrën e kryetares së Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pukë deri më 15.1.2016. Aktualisht mban detyrën e gjyqtarës së Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pukë.

Sipas të dhënave të regjistrit të procedimeve disiplinore, për gjyqtaren Flutura Hoxha përgjatë periudhës së rivlerësimit nuk është regjistruar asnjë kërkesë për procedim dhe nuk është dhënë asnjë masë disiplinore.

### **Analiza e gjetjeve i referohet të dhënave të nxjerra nga tri grupet e burimeve të informacionit:**

(i) formularit të vetëvlerësimit dhe dokumentacionit të paraqitur nga subjekti; (ii) pesë dosjeve të vëzhguara të përzgjedhura me short; si dhe (iii) të dhënat nga burimet arkivore në KLD.

Subjekti i rivlerësimit Flutura Hoxha, përgjithësisht ka aftësi në drejtim të interpretimit dhe zbatimit të ligjit. Në tri dokumentet ligjore dhe në pesë dosjet e vëzhguara, është konstatuar se identifikon normën ligjore të zbatueshme dhe jep arsye për mënyrën e zbatimit të saj në rastin konkret. Gjyqtarja Flutura Hoxha cilëson saktë veprën penale, për të cilën akuzohet i pandehuri

Tri dokumentet e përzgjedhura prej saj dhe pesë dosjet gjyqësore konfirmojnë njohuritë e saj mbi përgjegjësinë penale për veprat penale të vrasjes në rrethana të cilësuar dhe të mbajtjes pa leje të armëve luftarake, të shpërdorimit të kontributeve të dhëna nga shteti, të mashtrimit në sigurime, të vjedhjes së energjisë elektrike, si dhe njohuritë e saj mbi procedurën e saktësisimit të akteve të gjendjes civile, të vërtetimit gjyqësor të fakteve të marrëdhënies së punës dhe mbi procedurën e zgjidhjes së martesës.

Nga ana tjetër, ndër tri dokumentet ligjore dhe pesë dosjet e vëzhguara, janë ankimuar katër prej tyre. Në një rast, vendimi i dhënë nga gjyqtarja Flutura Hoxha është lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit Shkodër.

Subjekti i rivlerësimit Flutura Hoxha ka aftësi mesatare në arsyetimin ligjor. Vendimet gjyqësore përfundimtare të arsyetuara prej saj, janë të thjeshta dhe të kuptueshme. Ajo respekton rregullat e drejtshkrimit dhe përdor të gjitha karakteret e gjuhës shqipe, në funksion të qartësisë së arsyetimit të vendimit gjyqësor.

Rendimenti i përfundimit të çështjeve, bazuar në të dhënat e administruara është 85.3 %.

Sipas të dhënave statistikore të përcjella nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Pukë, për efekte të organizimit të shortit, konstatohet se për periudhën e rivlerësimit 8.10.2013 – 8.10.2016 gjyqtarja Flutura Hoxha, ka përfunduar së gjykuari 585 çështje, nga të cilat 272 çështje penale, 262 çështje civile të përgjithshme, 42 çështje familjare dhe 2 çështje zgjedhore. Ndër çështjet penale, 132 prej tyre janë krime dhe kundërvajtje penale. Ndërsa, ndër 262 çështje civile të përgjithshme, 147 prej tyre janë çështje civile me palë kundërshtare. Gjithashtu, gjyqtarja ka gjykuar edhe 62 çështje civile familjare.

Sipas germës “g”, pika 3, të Aneksit 1 të Sistemit të Vlerësimit, në aspektin sasior, gjyqtari i gjykatës së shkallës së parë, që nuk është e organizuar në seksione, duhet të jetë në cilësinë e relatorit në jo më pak se 200 gjykime çështjesh penale (krime dhe kundërvajtje) dhe çështjes civile me palë kundërshtare. Ky rregull nënkupton një ngarkesë sasiore prej jo më pak se 600 gjykime çështjesh të tilla për tre vjet. Gjyqtarja Flutura Hoxha, ka gjykuar gjithsej 341 çështje të tilla. Këto të dhëna tregojnë se ngarkesa sasiore e saj ka qenë nën standardin minimal. Në këtë aspekt, duhet theksuar se ngarkesa sasiore nuk është përgjegjësi e gjyqtarit, pasi ky i fundit do gjykojë aq çështje sa i bien atij me short. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Pukës përfaqëson një gjykatë me ngarkesë pune minimale. Rrjedhimisht, ky tregues merr rëndësi i kombinuar me shpejtësinë në gjykim dhe në arsyetimin e vendimeve gjyqësore.

Nga analiza e pesë dosjeve të përzgjedhura me short, rezultoi se kohëzgjatja e gjykimeve nga gjyqtarja ka qenë në intervale kohore nga 26 ditë deri në 4 muaj e 16 ditë. Çështja, që ka pasur

kohëzgjatjen më të lartë të gjykimit ka qene çështje civile themeli, në përfundim të gjykimit është disponuar me vendim themeli.

Për sa i përket kohëzgjatjes së gjykimeve në tri dokumentet ligjore të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit konstatohet se ato kanë zgjatur 1 vit 3 muaj e 26 ditë, 1 muaj e 4 ditë dhe 4 muaj e 18 ditë. Në dy nga tri dokumentet e prezantuara nga subjekti është respektuar afati standard i gjykimit. Në dosjen që i përket dokumentit nr. \*\*\* konstatohet se çështja ka qenë komplekse, me shumë të pandehur dhe shumë akuza në ngarkim të tyre, janë marrë shumë prova dhe është proceduar me gjykim të zakonshëm, në përfundim të të cilit gjykata ka caktuar dënim me burgim të përgjithshëm.

Lidhur me kohën mesatare të arsyetimit të vendimeve gjyqësore, si datë e arsyetimit të vendimit është vlerësuar data e dorëzimit të dosjes gjyqësore në sekretari, si e vetmja e dhënë objektive. Nga vëzhgimi i pesë dosjeve të shortuara është konstatuar se gjyqtarja Flutura Hoxha, përgjithësisht i ka kushtuar rëndësi arsyetimit në kohën e duhur vendimeve gjyqësore, duke respektuar në pjesën më të madhe afatet ligjore.

Subjekti i rivlerësimit Flutura Hoxha, përgjithësisht ka aftësi për të kryer procedurat gjyqësore. Dosjet e vëzhguara janë vënë në lëvizje pa vonesa prej saj, përmes vendimeve formale për caktimin e seancës përgatitore apo gjyqësore.

Gjyqtarja Flutura Hoxha zhvillon në mënyrë korrekte procedurën e gjykimit gjatë drejtimit të procesit gjyqësor, duke ndjekur hapat që lidhen me çeljen e seancës, verifikimin e palëve me të drejtat dhe detyrimet procedurale, si dhe për prezantimin e gjykatës. Në të gjitha rastet, disponon me vendime të ndërmjetme të cilat i shoqëron me referencë ligjore.

Nga vëzhgimi i pesë dosjeve gjyqësore të përzgjedhura me short nuk janë konstatuar mangësi në aftësinë për të administruar dosjet dhe për të mbikëqyrur saktësinë dhe plotësinë e akteve që përfshihen në të.

Sipas të dhënave nga regjistri i ankesave dhe i procedimeve disiplinore, nuk konstatohen të dhëna negative për etikën në punë të gjyqtarës Flutura Hoxha. Edhe nga vëzhgimi i pesë dosjeve nuk rezultuan të dhëna negative për këtë aspekt.

Nga të dhënat e deklaruara nga subjekti i rivlerësimit Flutura Hoxha dhe nga pesë dosjet e vëzhguara, konstatohet se nuk kanë dalë të dhëna në lidhje me imunitetin e saj ndaj çdo ndikimi apo presioni të jashtëm.

Nga tri dokumentet ligjore të paraqitura nga vetë subjekti dhe nga pesë dosjet e vëzhguara nuk janë evidentuar raste të konfliktit të interesit të subjektit të rivlerësimit Flutura Hoxha.

Në të tri dokumentet ligjore dhe në pesë dosjet e tjera të vëzhguara, nuk janë konstatuar raste që subjekti i rivlerësimit Flutura Hoxha nuk ka respektuar rregullat procedurale që lidhen me standardin e gjykatës së paanshme.

Në pesë dosjet gjyqësore të vëzhguara, në procesverbalin gjyqësor është konstatuar se gjyqtarja Flutura Hoxha komunikon me etikë me palët ndërgjyqëse, qoftë në seancat përgatitore, qoftë në seancat gjyqësore. Ajo ka aftësi komunikuese me palët ndërgjyqëse gjatë veprimtarisë përgatitore e gjyqësore, ku shfaq sjellje etike, duke ruajtur paanësinë në gjykim dhe respektuar barazinë e palëve.

Subjekti i rivlerësimit Flutura Hoxha i nënshtrohet detyrimisht programit të formimit vazhdues të Shkollës së Magjistraturës. Në periudhën e rivlerësimit ka marrë pjesë dhe është certifikuar në tetë trajnime<sup>11</sup> dhe seminare të organizuar nga Shkolla e Magjistraturës (shihni të dhënat tek

---

<sup>11</sup>Në shtesë të 7 trajnimeve të deklaruara sipas vërtetimit të lëshuar nga Shkolla e Magjistraturës në rubrikën “trajnimet në 3 vitet e fundit”, gjyqtarja Flutura Hoxha ka paraqitur edhe një certifikatë për një trajnim të kryer prej saj në këtë shkollë, pas datës së lëshimit të vërtetimit nga shkolla, siç pasqyrohet në rubrikën “dokumente të tjera”.



rubrika “trajnimet në 3 vitet e fundit). Këto të dhëna tregojnë se ka marrë pjesë në 12 ditë të formimit vazhdues për një periudhë trevjeçare. Lënda e trajnimeve, ku ka marrë pjesë, ka një lidhje të arsyeshme me detyrën e gjyqtarit të shkallës së parë, të paorganizuar në seksione.

#### **D. DENONCIMET NGA PUBLIKU**

Për subjektin e rivlerësimit janë regjistruar në Komision tetë denoncime.

##### **1 Denoncim nr. \*\*\* prot., datë 10.1.2019, i shtetasit F.Gj**

**1.1** Ky shtetas ka denoncuar një prokuror një shef komisariati, një avokat, gjithashtu, edhe subjektin e rivlerësimit për shkelje të të drejtave të njeriut, të cilët kanë vepruar si gjobëvënës dhe jo punonjës shtetërorë. Denoncuesi tregon ngjarjen e ndodhur, ku sipas tij, *në kundërshtim të plotë me ligjet e Kushtetutës, i kanë montuar denoncim*. Denoncuesi F.Gj pretendon se *është gjendur rastësisht në rrugë dhe ka parë makina të ndaluara dhe ka kujtuar se është aksident, por sapo është afruar aty e kanë sulmuar dhe ofenduar*. Më pas e kanë mbajtur në qeli me masë sigurie 96 orë (dhe jo 72 orë siç e parashikon ligji), si dhe pas 6 ditësh, i është bërë ekspertiza, ku, ka dalë 9 ditë i paaftë.

Denoncuesi flet për arrestimin që i është bërë atij në datën 6.9.2013 dhe procesin gjyqësor të zhvilluar ndaj tij me gjyqtare subjektin e rivlerësimit.

**1.2** Në lidhje me këtë denoncim dhe rrethanat e përmendura, subjektit iu kërkua të japë shpjegime për këtë fakt konkret.

**1.3** Në përgjigje të rezultateve të hetimit, subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar se *ky denoncim është i pabazuar, pasi rezulton se ndaj vendimit nr. \*\*\*, datë 7.3.2014, shtetasi i mësipërm nuk ka bërë ankim dhe vendimi ka marrë formë të prerë*.

**1.4** Sa më sipër, rezulton se subjekti dha shpjegime bindëse në lidhje me këtë denoncim dhe bashkë me prapësimet ka sjellë vendimin nr. \*\*\*, datë 7.3.2014, ku ankuesi F.Gj nuk ka ushtruar ankim ndaj këtij vendimi dhe, si i tillë, ka marrë formë të prerë.

**1.5** Nuk u konstatuan mosrespektim procedurash nga subjekti, gjatë procesit të vendimmartjes.

##### **2. Denoncim anonim nr. \*\*\* prot., datë 15.1.2021**

Denoncuesja deklaroi se është punonjëse e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pukë dhe kërkon të mbetet anonim. Ajo ka denoncuar subjektin e rivlerësimit *për fshehje pasurie dhe korrupsion*. *Gjyqtarja ka fshehur pasurinë, pasi ka dy apartamente në emër të familjarëve të saj. Gjithashtu, në Pukë ajo ka një banesë, një magazinë dhe një lokal që i përdor babai i saj B.H. Gjithashtu, denoncon subjektin për sjellje jo etike me punonjësit e gjykatës dhe se ka përfutur padrejtësisht nga buxheti i gjykatës e për këtë ka edhe raport auditi, ku evidentohen shkeljet e ku për këtë shkak është shkarkuar nga puna edhe një punonjëse e financës. Ajo shton se në ardhmen do të denoncojë përsëri ...*

Referuar këtij denoncimi anonim, Komisioni vlerësoi se, për sa i përket aspektit të kontrollit të krijimit dhe ligjshmërisë së pasurisë së subjektit, e ushtron këtë funksion nëpërmjet hetimit administrativ të thelluar të kriterit të pasurisë sipas ligjit nr. 84/2016. Ndërsa, për sa i përket denoncimit, në lidhje me menaxhimin efikas apo jo të buxhetit të funksionimit administrativ të gjykatës, janë instanca të tjera kontrolluese dhe jo Komisioni.

Lidhur me aspektin e pasurisë, Komisioni i ka vlerësuar në kriterin e pasurisë pretendimet e paraqitura nga denoncuesi anonim.

### **3. Denoncim nr. \*\*\* prot., datë 20.4.2018, i shtetasit R.D**

Ky denoncues ka denoncuar shumë subjekte rivlerësimi, ndër to, edhe subjektin Flutura Hoxha. Ndërsa lexohet denoncimi, vihet re numri i madh i subjekteve që ai përmend, ku flet për një gjyq të Gjykatës së Apelit Shkodër, por nuk shpjegon më gjatë situata e rrethana të caktuara apo nuk citon një vendim, ku gjyqtare të kishte qenë subjekti i rivlerësimit.

Në këto kushte, Komisioni nuk hetoi, më tej, mbi këtë denoncim.

### **4. Denoncim nr. \*\*\* prot., datë 18.11.2020, i shtetasit P.M**

Ky denoncues ka denoncuar subjektin e rivlerësimit për të cilën *ka kërkuar përjashtimin e saj në gjyqin që kishte me të dhe ajo përkundrazi ka lajmëruar komisaratin për shoqërimin e tij. Ka stonuar në përjashtimin e një gjyqtari tjetër dhe ka tjetërsuar gjyqin që kishte me të duke dënuar të tjerë ta pafajshëm.* Denoncuesi në këtë mënyrë citon kërkesën e tij drejtuar Komisionit.

Bazuar në përmbajtjen dhe formën e paraqitjes së denoncimit, Komisioni konstatoi se mungojnë elementet për hetimin e mëtejshëm ndaj subjektit të rivlerësimit.

### **5. Denoncim nr. \*\*\* prot., datë 6.3.2018, i shtetasit S.P**

Ky shtetas ka denoncuar subjektin e rivlerësimit për dhënie vendimi të padrejtë, për shkak se gjyqtarja Flutura Hoxha nuk ka pranuar asnjë kërkesë ligjore për kryerje veprimesh procedurale të domosdoshme në një proces gjyqësor. Denoncuesi liston një sërë ankesash, por nuk referon proces apo vendim gjyqësor konkret.

Në këto kushte, Komisioni nuk vlerësoi të hetojë, më tej, për këtë denoncim.

### **6. Denoncim nr. \*\*\* prot., datë 9.1.2018 dhe nr. \*\*\* prot., datë 27.12.2018, i përsëritur i shtetasit Z.P**

Ky denoncues ka denoncuar subjekte të tjerë, ndër to, edhe subjektin e rivlerësimit për shkak të padrejtësive të bëra nga eksponentë të drejtësisë, përfshirë edhe gjyqtaren Flutura Hoxha. Denoncuesi ankohet për vendim të padrejtë në dhënien e vendimit me objekt bashkimin e dy dënimeve të dy gjykatave të ndryshme, vendime të cilat kishin marrë formë të prerë dhe ishte nxjerrë urdhërekzekutimi për secilin prej tyre.

Referuar vendimit objekt ankimi në Komision (bashkëlidhur denoncimit nr. \*\*\* prot.) vërehet se subjekti i rivlerësimit, në cilësinë e gjyqtares së kësaj çështjeje, nuk ka kryer shkelje procedurale dhe duket se ka dhënë vendim në përputhje me dispozitat e Kodit të Procedurës Penale.

### **7. Denoncim nr. \*\*\* prot., datë 18.1.2019, i shtetasit V.N**

Ky shtetas ka denoncuar subjektin e rivlerësimit për dhënie vendimesh të padrejta dhe qartazi të njëanshme. Ai sjell bashkëlidhur ankesës së tij shumë akte ligjore, si dhe shumë vendime gjyqësore, ku në objekt të tyre ka qenë kërkesa për përjashtimin e gjyqtares Flutura Hoxha.

Denoncuesi liston një sërë ankesash, por nuk referon proces apo vendim gjyqësor konkret.

Në këto kushte, Komisioni vendosi mos të hetojë, më tej, për këtë denoncim.

### **8. Denoncim nr. \*\*\* prot., datë 10.4.2019, i shtetasit L.D**

Ky shtetas denoncon vendimin e datës 23.2.2018, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pukë, e cila ka vendosur “mospranimin e kërkesës për rishikim të vendimit të formës së prerë nr. \*\*\*, datë 22.4.2013”. Sipas denoncuesit *vendimit i ka munguar gjykimi objektiv i provave shkresore.*

**8.1** Lidhur me këtë denoncim dhe rrethanat e përmendura, subjektit iu kërkuan shpjegime në lidhje me ecurinë e procesit gjyqësor, si dhe kopje të vendimeve përkatëse.

**8.2** Në përgjigje të rezultateve të hetimit, subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar se *vendimi nr. \*\*\**, datë 23.2.2018, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pukë është ankimuar në Gjykatën e Apelit Shkodër, e cila me vendimin nr. \*\*\*, datë 3.5.2018, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të mësipërm.

**8.3** Subjekti ka prapësuar se ky vendim është ankimuar në Gjykatën e Apelit Shkodër, ku kjo e fundit e ka lënë në fuqi këtë vendim.

**8.4** Për të shpjeguar më shumë, gjyqtarja Flutura Hoxha ka deklaruar më parë të pafajshëm shtetasin L.D, akuzuar për kryerjen e veprës penale “mbajtje pa leje e armëve dhe municioneve luftarake”. Gjykata e Apelit Shkodër ka ndryshuar vendimin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pukë, duke e deklaruar fajtor shtetasin L. D për veprën penale “mbajtje pa leje e armëve dhe municioneve luftarake”. Ankuesi ka ushtruar rekurs dhe Gjykata e Lartë ka vendosur rishikimin e vendimit të Gjykatës së Apelit Shkodër dhe e ka dërguar përsëri për gjykim në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Pukë. Subjekti pas gjykimit, ka vendosur “mospranimin e rishikimit të vendimit të Gjykatës së Apelit Shkodër”.

**8.5** Sa vërehet nga përmbajtja e vendimit që subjekti sjell, nuk konstatohen shkelje apo gjykim i padrejtë prej saj.

Ndërsa, në lidhje me dy denoncime nga publiku për subjektin e rivlerësimit nr. \*\*\* prot., datë 15.2.2022 dhe nr. \*\*\* prot., datë 14.2.2022, të cilat kanë mbërritur në Komision pas dërgimit të rezultateve të hetimit subjektit, pas gjykimit nga Komisioni, nuk u morën parasysh.

Për sa më sipër, Komisioni, pasi kreu hetim të hollësishëm mbi këto denoncime, në mbështetje të nenit 53 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, arriti në përfundimin se nuk ekzistojnë fakte apo rrethana që mund të përbëjnë prova në lidhje me kriteret e rivlerësimit për subjektin e rivlerësimit.

Në përfundim, trupi gjykues vlerëson se në bazë të rrethanave dhe kushteve të mësipërme, subjekti i rivlerësimit ka treguar cilësi të mira në punë, është efiçente dhe konsiderohet “e aftë”, duke arritur në përfundimin se subjekti i rivlerësimit ka nivel kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale.

## **V. VLERËSIMI TËRËSOR I ÇËSHTJES**

Në vlerësimin tërësor të çështjes, mbështetur në provat, faktet dhe rrethanat që Komisioni disponon për kriterin e vlerësimit të pasurisë, vlerësimit të figurës dhe vlerësimit profesional, si dhe në vlerësim tërësor të procedurave, arrin në përfundimin se:

### **Për vlerësimin e pasurisë**

Komisioni, bazuar në provat që disponon, në vlerësimin e çështjes në tërësi, si dhe bindjen e brendshme, çmon se faktet në lidhje me kriterin e pasurisë të krijojnë bindjen se subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar saktë pasuritë dhe ligjshmërinë e burimit të krijimit, për arsyet e përmendura në këtë vendim në rubrikën “vlerësimi i pasurisë”.

Rezultoi se subjekti ka bërë deklaram të pasaktë, të paplotë dhe ka mungesë të burimeve financiare lidhur me pasuritë, si dhe ka pamundësi financiare për blerjen e pasurive, për të përballuar me burime të ligjshme financiare kryerjen e shpenzimeve dhe shtesën e kursimeve, ndër vite, duke rezultuar me një mungesë burimesh të ligjshme në vlerën 5,257,890 lekë, duke u gjendur në kushtet e parashikimit të germës “b”, të pikës 5, të nenit 33, të ligjit nr. 84/2016.

Komisioni konstatoi se subjekti ka bërë deklaram të pamjaftueshëm për pasuritë, si dhe nuk justifikon me burime të ligjshme krijimin e tyre, sipas përcaktimeve të germës “b”, të nenit 33/5, të ligjit nr. 84/2016.

Duke u gjendur në këtë mënyrë në plotësim të kushteve të parashikuara nga pika 1, e nenit D, të Aneksit të Kushtetutës, e cila parashikon se: *“Subjektet e rivlerësimit i nënshtrohen deklarimit dhe kontrollit të pasurive të tyre, me qëllim që të identifikohen ata që kanë në pronësi ose në përdorim pasuri më të mëdha nga sa mund të justifikohen ligjërisht ose ata që nuk i kanë deklaruar saktësisht dhe plotësisht pasuritë e tyre dhe të personave të lidhur”*, ndërkohë që subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar saktë pasuritë në përdorim.

Pika 3, e nenit D, të Aneksit të Kushtetutës, parashikon se: *“Subjekti i rivlerësimit duhet të shpjegojë bindshëm burimin e ligjshëm të pasurive dhe të të ardhurave. Pasuri të ligjshme për qëllimet e këtij ligji konsiderohen të ardhurat që janë deklaruar dhe për të cilat janë paguar detyrimet tatimore. Elemente të tjera të pasurisë së ligjshme përcaktohen me ligj”*, ndërkohë që subjekti i rivlerësimit nuk ka shpjeguar bindshëm burimin e ligjshëm të të ardhurave të përmendura në këtë vendim.

Pika 5, e nenit D, të Aneksit të Kushtetutës, parashikon se: *“Nëse subjekti i rivlerësimit përpiqet të fshehtë ose të paraqesë në mënyrë të pasaktë pasuritë në pronësi, posedim ose në përdorim të tij, zbatohet parimi i prezumimit në favor të masës disiplinore të shkarkimit dhe subjekti ka detyrimin të provojë të kundërtën”*, ndërkohë që subjekti i rivlerësimit ka paraqitur në mënyrë të pasaktë pasuritë në përdorim të saj.

Subjekti gjendet në kushtet e germave “a” dhe “b”, të pikës 5, të nenit 33, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

Subjekti i rivlerësimit gjendet në kushtet e pikës 5, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës dhe gërmes “c”, të nenit 33, të ligjit nr. 84/2016.

Në rastin e subjektit të rivlerësimit Flutura Hoxha, për kriterin e vlerësimit të pasurisë, vërtetohen shkaqet që neni D i Aneksit të Kushtetutës i ka parashikuar të tilla që të zbatohet parimi i prezumimit në favor të masës disiplinore të shkarkimit.

Mbështetur në konkluzionet e mësipërme, Komisioni çmon se subjekti i rivlerësimit nuk ka arritur nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë, në kuptim të pikës 3, të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016.

### **Për vlerësimin e figurës**

Nga hetimi administrativ nuk u gjetën elemente që të vërtetojnë ekzistencën e kontakteve të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës. Deklarimet e subjektit të rivlerësimit rezultuan të sakta dhe të vërteta. Trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit Flutura Hoxha ka arritur një nivel të besueshëm në kontrollin e figurës.

### **Për vlerësimin e aftësive profesionale**

Në përfundim, lidhur me kriterin profesional për pesë çështjet e shortuara, trupi gjykues, pas vlerësimit të parashtrimeve dhe provave të paraqitura nga subjekti dhe propozimit të relatorit të çështjes, arrin në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit ka arritur një nivel minimal kualifikues, në kuptim të gërmes “c”, të nenit 59, të ligjit nr. 84/2016.

## **KONKLUZION PËRFUNDIMTAR**

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, pasi u njoh me rrethanat e çështjes, bazuar në provat e administruara, raportin dhe rekomandimet e relatorit të çështjes, dëgjoi subjektin e rivlerësimit në seancë dëgjimore publike, si dhe mori në shqyrtim të gjitha pretendimet dhe provat e parashtruara nga subjekti i rivlerësimit për vlerësimin e kriterit të pasurisë, sipas paragrafit 2, të nenit 4, të ligjit nr. 84/2016, arrin në konkluzionin se subjekti i

rivlerësimit Flutura Hoxha ka arritur nivel të pamjaftueshëm për kriterin e pasurisë, duke u gjendur në kushtet e pikës 3, të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016.

### **PËR KËTO ARSYE,**

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, bazuar në pikën 5, të nenit 55, të ligjit nr. 84/2016, pasi u mbledh në dhomë këshillimi, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Francesco Ciardi, referuar germës “c”, të pikës 1, të nenit 58, dhe të pikës 3, të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

### **V E N D O S I:**

1. Shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit Flutura Hoxha, gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Pukë.
2. Vendimi, i arsyetuar me shkrim, u njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë, 30 ditë pas përfundimit të seancës dëgjimore dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit, në përputhje me pikën 7, të nenit 55, të ligjit nr. 84/2016.
3. Ky vendim ankimohet në Kolegjin e Posaçëm të Apelit nga subjekti i rivlerësimit dhe/ose Komisioneri Publik 15 ditë nga data e njoftimit të vendimit të Komisionit.
4. Ankimi depozitohet në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit.  
Ky vendim u shpall në Tiranë, në datën 25.2.2022.

### **ANËTARËT E TRUPIT GJYKUES**

**Etleda ÇIFTJA**  
**Kryesuese**

**Roland ILIA**  
**Relator**

**Pamela QIRKO**  
**Anëtare**

*Sekretare gjyqësore*  
*Amela Idrizi*